



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec



01 Nr. 03/24
Rahovec, 19.3.2024

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal që të marrin pjesë në mbledhjen e tretë (3), e cila do të mbahet më:
28 mars 2024 (enjte), me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 dhe 2023, në vitin 2024;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndarjen e P-02658-0 ZK-Rahovec dhe formimi i parcelës së re në emër të Komunës së Rahovecit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër nga 1-15 vjet për organizatat e shoqërisë civile, P-00301-3 ZK-Bërnjak;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00301-3 ZK-Bërnjak;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për subvencionimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2024;
8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit në Rahovec;
9. Shqyrtimin i Raportit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm;
10. Shqyrtimi i informatës për menaxhimin e Aseteve Komunale;
11. Shqyrtimi i informatës mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre;
12. Shqyrtimi i informatës rreth Programit për Banim për vitin 2023.

KRYESUESI I KUVENDIT

Arbër Zenuni



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec



Komiteti për Politikë dhe Financa

Në bazë të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, si dhe nenit 32 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e vet të mbajtur më **18.3.2024**, për këtë mbledhje është propozuar ky:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 dhe 2023 në vitin 2024;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndarjen e P-02658-0 ZK-Rahovec dhe formimi i parcelës së re në emër të Komunës së Rahovecit;
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër nga 1-15 vite për organizatat e shoqërisë civile, P-00301-3 ZK-Bërnjak ;
5. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00301-3 ZK-Bërnjak;
6. Të ndryshme.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa i drejtohen kuvendit komunal me këtë:

R E K O M A N D I M

- Kuvendari Dëfrim Kafexhiu ka propozuar që pikës së dytë e rendit të ditës (pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve), t'i ndryshohet emërtimi para aprovimit të rendit të ditës.
 - Po ashtu, kuvendarja Shqipe Kryeziu, propozoi që pika e dytë e rendit të ditës, nga mbledhjet e kuvendit, të jetë si pikë e fundit në rend dite.
1. Pika e parë është aprovuar në mënyrë unanime, pa ndonjë vërejtje;
 2. Pika dytë e rendit të ditës është rekomanduar që t'i kalojë Kuvendit unanimit, po ashtu kuvendari Burim Krasniqi ka kërkuar që si material shtesë të ketë edhe arsyetimin e bartjes së mjeteve të projektet e propozuara;
 3. Pika e tretë e rendit të ditës është rekomanduar që t'i kalojë Kuvendit për shqyrtim në mënyrë unanime;
 4. Pika e katërt e rendit të ditës është rekomanduar që t'i kalojë Kuvendit për shqyrtim, me 4 - për , 1 - kundër dhe 1 - abstenim;
 5. Pika e pestë është rekomanduar që t'i kalohet Kuvendit për shqyrtim, me 5 - për, 1 - kundër;
 6. Në pikën “të ndryshme”, ka pasuar disa diskutime.

Kryesuesi i Kuvendit

Arber Zenuni



P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.02.2024**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston.

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! Ju lutem që në shenjë nderimi, ta nderojmë me një minutë heshtje, ish Kryetarin Qazim Qeska... Lavdi! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, Nënkryetar **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje të dytë të vitit 2024, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.325/22, i datës 31.5.2022, për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim;
4. Shqyrtimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.174/23, i datës 27.12.2023, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2024;
5. Shqyrtimi i vendimit për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe të shesheve në Komunën e Rahovecit;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për të zhvilluar procedurat e konkurrimit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë personave fizikë dhe juridikë, deri në 25 (njëzet e pesë) vjet, P- 02302-0 dhe 02299-0, ZK- Rahovec.
7. Raporti nga Zyra e Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 dhe diskutimi i planit të veprimit;
8. Raporti mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga ZKA-ja, për vitin 2022;
9. Raporti i Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2023;
10. Informatë e DKA-së për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/2024;
11. Informatë mbi kontratat publike të Komunës së Rahovecit;

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë, ju informoj që si pikë shtesë për seancën e sotme kemi edhe një pikë: **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-02302-1 dhe 02299-0, zk-Rahovec.** Me lejen tuaj këtë pikë e vendosim në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash nga anëtarët e kuvendit votohet pika shtesë e rendit të ditës. Tani vazhdojmë rendin e ditës si të tillë e kalojmë në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash votohet edhe rendi i ditës i paraparë për këtë seancë të kuvendit.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi: A kemi ndonjë koment apo diskutim nga anëtarët e kuvendit rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Unanimisht aprovet pika e parë e rendit të ditës.

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;

Fahrije Lushi: I nderuar kryesues, kryetar, të nderuar kolegë këshilltarë, medie. Jam sot këtu për ta ngritur një shqetësim të veçantë, i cili ka qenë thuarje ngjarje e jashtëzakonshme për familjen time. Ka ndodhur një vjedhje në

familjen time në fshatin Ratkoc, të gjithë jeni solidarizuar dhe në veçanti theksoj reagimin e Kryetarit të Komunës z. Smajl Latifi, i cili thirr mbledhjen urgjente të KKS-së dhe të gjithë zyrtarët permanentë për këtë çështje. Unë si anëtare e asaj familje, ndihem mjaft e shqetësuar dhe është mirë që kryetari e ka thirrur mbledhjen e KKS-së, mirëpo mendoj dhe kërkoj nga kryetari një përgjigje se si të veprojmë në këtë rast, ose cili do të ishte reagimi i tij, përveç asaj që “jo panik për qytetarët”! Qytetarët janë në panik edhe pas rastit në Krushë të Madhe, i cili e rriti edhe më shumë këtë shqetësim. Në ngjarjen e fundit që ka ndodhur në Ratkoc, sapo ka arritur policia në vendin e ngjarjes, ata kanë prononcuar se para pak çasteve e kishin realizuar një patroll policore në atë zonë. Mirëpo, sa i ka siguruar kjo patroll anëtarët e familjes sime që të evitohet kjo ngjarje. Andaj, me sinjeritet dhe mirëkuptim nga të gjithë ju dhe nga kryetari i komunës, kërkoj që të dalim me një argument pas kësaj ndodhie.

Kryetari: Përshëndetje për kryesuesin e kuvendit të komunës, drejtorët e drejtorive, anëtarët e kuvendit, përfaqësues të KFOR-it, OSBE-së, mediave. Të them të drejtën isha në mëdyshje a të flas, ose jo për këtë temë, në mënyrë që të konsumohet debati. Dua t’ju jap vetëm një informacion të shkurtër për ecurinë, pas këtyre ndodhive në disa lokalitete të Komunës së Rahovecit. Ju konfirmoj që nuk besoj që kam dalur përtej kompetencave të mia, por këto ditë kam qenë i angazhuar sikur në vitet 98-99, me të gjitha organet dhe kapacitetet. Kam takuar hetues, prokurorë dhe qytetarë të prekur. Dje ka qenë një sublimim i një angazhimi të pashoq, si administratë komunale me përputhje me përgjegjësitë që i kemi. Angazhim të madh kanë bërë edhe organet tjera si: Policia, hetuesia, AKI-ja dhe organet tjera profesionale. Ne e dimë një verdikt tanimë, të gjyqtarit hetues të Gjykatës Themelore – Gjakovë. Pa pasur nevojë ta bëj publike kam kërkuar menjëherë, jo vetëm shtimin e patrullave, por më shumë se kaq. Ju konfirmoj që rasti në Krushë dhe Ratkoc janë duke u trajtuar me seriozitet. Procesi është duke shkuar në rrugë të mbarë dhe për pak ditë do të kemi identitetin e atyre që kanë marrë pjesë në plaqkitje të armatosur, në rrahje, tortur dhe gjuajtje me armë për më shumë se gjysmë ore. Më herët, raste të tilla ka pasur edhe në Opterushë, Fortesë, Retijë të Ulët dhe Retijë. Sot gjithashtu, kam takime të rëndësishme me strukturat të cilat e kanë fokus këtë temë. Mbetet një gjendje pak shqetësuese, sepse edhe unë i përfilli emocionet e qytetarëve. I ftoj anëtarët e kuvendit të komunës, qytetarët e komunës së Rahovecit që ta thellojnë bashkëpunimin me administratën dhe posaçërisht me organet e rendit dhe jam shumë i sigurtë që nuk do të ketë qetësi dhe rehati për keqbërësit. Unë jam i vetëdijshëm se çka po flas dhe qytetarët nuk kanë nevojë të jenë në panik. Në gjysmë të natës dal e lëviz pa problem, sepse në konceptin tim nuk ka pasiguri. E kuptoj gjithashtu emocionin e qytetarëve dhe shqetësimet e tyre. Në mbledhjen e KKS-së në cilësinë e kryetarit jam kujdesur t’i fus në funksion edhe disa instrumente që nuk janë praktika në Republikën e Kosovës. Ka qenë i ftuar drejtori i drejtorisë rajonale, i cili e ka dërguar zv. drejtorin, një personalitet jashtëzakonisht me përvojë dhe i ditur për këto lloj situatash. Kanë qenë të ftuar shefat e partive politike në kuvend dhe kryetarët e këshillit të fshatrave. Ka qenë një mbledhje që e ka dërguar mesazhin e qartë tek organet profesionale të vendit. Pasi të kryhet mbledhja, mund t’ju ftoj në zyre, kushdo që është i interesuar që të diskutojmë më thellë rreth kësaj që e paraqita në foltore.

Sinan Kryeziu: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. E mora fjalën meqenëse edhe unë jam viktimë e hajnave. Fillimisht dua t’i shpreh keqardhje koleges në Ratkoc dhe familjes në Krushë, uroj që mos të ndodhin raste të tjera. Konsideroj që këtu kemi problem me kodin penal të Republikës së Kosovës. Mendoj që është kompetencë e legjislativit (parlamentit) që t’i bëjë hapat për ndryshim të kodit penal. Duhet ta marrim Amerikën si model të demokracisë, sepse amerikanët e kanë kodin penal që në momentin që preket prona private (që është e shenjtë për të gjithë njerëzimin) ata e ekzekutojnë dhe nuk kanë përgjegjësi penale. Mendoj që duhet të bëjmë presion publik në legjislativ për ta ndryshuar kodin penal. Në momentin kur ndryshohet, hajnat duke i ditur pasojat, ndalen. Për hajninë, kodi penal i Kosovës parasheh burgim 1 deri 5 vjet, që është shumë pak.

Bejtullah Deliu: Faleminderit kryesues! (kryetari nuk është), drejtorë të drejtorive, asambleistë, media dhe të gjithë të pranishëm. E kam një lavdatë dhe ndoshta një kritikë të vogël. Në lidhje me mbeturinat (zakonisht inerte) edhe pse ka vend adekuat për hudhje të tyre, por ka qytetarë të papërgjegjshëm që hudhin vend e pavend. Falë angazhimit të drejtoreshës për Inspektion dhe Drejtorit Përparim Krasniqi, i cili ka qenë një bashkëpunues shumë i mire. Me këto hudhje të mbeturinave, financiarisht nuk jam dëmtuar fatmirësisht. Në të ardhmen nuk do të thotë që nuk do të ndodh. Ndoshta është e udhës të shqyrtohet se a është mungesë e inspektorëve, që këto raste mos të na ikin pa dënime individuale dhe mos të kemi telashe me pronat tona që i kemi. Gjithashtu mora vesh që kostoja për deponinë legale është shumë solide. Mendoj që drejtoritë përkatëse duhet të bëjnë fushatë sensibilizuese në lidhje me këtë gjë. Pika tjetër ka të bëjë me pavarësinë. Me 17 Shkurt kemi festuar ditën e Pavarësisë dhe program për katër ditë

me 8 pika festive është me 14, 15, 16 shkurt, shumë pak dhe e zbehtë, sepse në ora 12 të ditës ka përfunduar çdo send me një program artistik. Organizatorët të cilët kanë qenë, nuk e di a janë adekuatë në kulturë ose vullneti ka qenë shumë i vogël. Pas ores 12 me 17 shkurt nuk ka pasur asnjë aktivitet, por veç formalitet dhe për mua është me të vërtetë shqetësuese. Festohet në mënyrën më të mire vjelja e rrushit, festivali i specit në Krush të Madhe e në këtë rast 17 shkurti jo, atëherë është shqetësuese.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! I nderuar ekzekutiv, kolegë asambleistë, përfaqësues të KFOR-it, monitorues, medie, të pranishëm. Kryesues, besoj që jam brena minutazhës, por dua të filloj pak më ndryshe. Po e them një barcoletë të vogël: Miu me elefantin mbi urë, gjatë ecjes miu ia bën elefantit: “shiko elefant se si dridhet ura, kur po ecim ne të dy”. Pak ka këtu që e dridhin urën, mos të ndihen elefant. E dyta, është shqetësuese sepse askush askend nuk e bën të madh, e as të vogël, por respekti e nderon edhe atë që e respekton dikë tjetër. Në seancën komemorative për të ndjerin, ish kryetarin Qazim Qeska, kam kërkuar fjalën për të respektuar të nderin, familjarët dhe të pranishmit. Është e dhimbshme që mos të jetë e turpshme, kur shefi i kabinetit të kryetarit i thotë moderatores: prezantoje asambleist i asamblesë komunale në Rahovec. Unë kam qenë si kryetar i LDK-së dega në Rahovec për ta nderuar aktivitetin. Secilit prej neve na jep pozicionin qytetari, apo strukturat të brendshme dhe kërkoj mirëkuptimin që mos të tentohet me veprime të tilla të zbehet dikush, sepse nuk e meriton askush. Tjetra, kam disa pyetje në emër të grupit të asambleistëve: Te Drejtoria e Financave, sa kemi procedura përmbarimore (prej operatorëve dhe prej kontratës kolektive)? Sa është vlera bazë dhe sa janë shpenzimet të tjera përmbarimore, gjyqsore, kamata? Te Drejtoria e Shërbimeve Publike, kërkoj një informatë të plotë se në cilat rrugë është intervenuar në mirëmbajtje gjatë vitit 2023 (në sanimë)? Sa është sipërfaqja e sanuar? Te Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, te kompleksi sportiv te E-Prokurimi më ka rastisur të shoh tender “për punë të paparapara” më 11.10.2023 dhe 16.10.2023. Vlera është 34.900€ për secilën dhe në total del të jetë rreth 70.000€. Nuk e kuptoj ende nëse është bërë ndonjë punë, janë shpallur tenderë të negociuar edhe për rreth 70.000€ të tjera Cila është arsyeja e tenderimit dhe cila kompani e ka fituar këtë tender?

Kryetari: Ne nuk do të përgjigjemi në seancën e sotme në asnjë pyetje që parashtrohet nga asambleistët sot. Arsyeja themelore është për ta menaxhuar më mirë kohën dhe në seancën e ardhshme, natyrisht të gjitha pyetjet me shkrim ose me gojë do t’ju përgjigjemi. Ta ndërtojmë një praktikë të re dhe ju mund t’i depononi pyetjet. Sikurse Burimi, kryetari i lidhjes demokratike – dega Rahovec, gjithashtu uroj që të jetë edhe anëtar i kryesisë në shkallë vendi. Mendoj që ajo në mbledhjen komemorative ka qenë gabim teknik, sepse ne i respektojmë të gjithë qytetarët dhe mos të flasim për njerëz që janë të veshur me përgjegjësi. Përndryshe, po e përsëris që, Burim Krasniqi aktualisht është kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, dega Rahovec dhe uroj që edhe në zgjedhjet e ardhshme të partisë të mbetet kryetar i degës.

Lirigon Kastrati: Faleminderit kryesues, ekzekutiv, kolegë anëtarë të kuvendi, qytetarë të komunës së Rahovecit, media. Për Drejtorinë e Shërbimeve Publike i kam realisht 2-3 kërkesa të qytetarëve. Fillimisht, një kërkesë nga qytetarët e fshatit Hoçë e Vogël dhe Nagac. Rruga që i lidh këto dy fshatra, një pjesë ka mbetë e pakubëzuar dhe kërkojmë kubëzimin apo siç e keni planifikuar ju për këtë vit? Çështja tjetër ka të bëjë me ndriçimin publik përgjatë rrugës kryesore. Ka mbetur një pjesë në mes të fshatit Krushë e Madhe dhe Nagac, kur do të intervenoni në këtë pjesë? Në seancën paraprake e kemi ngritur shqetësimin për rikthimin e ndriçimit publik, kam pritur që vitin e kaluar të merrni masa, tani jemi në muajin e tretë të vitit 2024. Kur pritet të rikthehet ndiçimi publik në lagjet e fshatit Hoçë e Vogël?

Melinda Iska: Faleminderit kryesues! Përhëndetje për juve, kryetarin, nënkryetarin, drejtorët e drejtorive, kolegët asambleistë, të gjithë që janë të pranishëm. Sot, dua të flas për infrastrukturën rrugore në komunën tonë, me theks të veçantë në qytetin e Rahovecit. Gjendja e rrugëve tash e një kohë nuk është e kënaqshme. Arsyetimet e juaja kanë qenë që gjendja jo e mirë e rrugëve është shkaku i projekteve që janë duke u punuar. Nëse e marrim shembull projektin e sheshit në qendër dhe intervenimet që janë bërë në rrugë kanë përfunduar pothuajse dy muaj. Rruga nuk është kthyer në gjendjen e mëparshme, përveç bllokimit që po bëhet në atë pjesë të qytetit, kjo po i shkakton problem qytetarëve në qarkullim. Po ashtu, ka disa muaj që kanë përfunduar punimet në rrugën “Gëzim Hamza – Piktori” saktësisht te trafa dhe rruga ende nuk është rregulluar. Komuna po investon në projekte me vlera të mëdha financiare, por nuk po arrin të bëjë mirëmbajtjen e rrugëve pas përfundimit të projekteve. Kur do të rregullohen këto segmente? Gjithashtu shqetësim kemi edhe në lagjen ku unë jetoj, rr. “Xhafer Nurkasa” dhe “Gëzim Mullabazi” që gjendet në të njëjtën lagje afër shoqatës “Hareja”, d.m.th jo larg vendit ku jeton ti kryetar. Këto dy

rrugë janë në gjendje të mjerueshme, janë të dëmtuara, kanë probleme me ujëra fekale dhe atmosferike. Kryetar, a keni ndonjë plan t'i rregulloni këto rrugë?...

Eqrem Spahiu: Faleminderit kryesues! Përsëritet kryetar, kolegë asambleistë, të pranishmit në sallë. Gjatë këtyre ditëve kanë filluar punimet për disa shtigje të ecjes në mallet e Zoqishtit dhe Optrushës. Shumë mirë, kemi nevojë edhe për shtigje. Por, kryetar, nevoja më e madhe e këtyre dy fshatrave është për një rrugë fushore që lidhë Zoqishtin, Optrushën dhe Retijën. Rreth 80 ha janë pa rrugë, por edhe disa rrugë të tjera që kurrë nuk është shtruar asnjë meter shavorr. Ka disa vite që në varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në fshat, intervenohet vetëm sipërfaqësisht që kinse po bëhet diçka. Pllakat e varrezave janë të demoluara m'u në prag të përvjetorit të martirëve. Një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, në seancën e kaluar diskutova rreth një pusete të hapur në rr. "Jahja Danuza" dhe e njëjta ka shumë kohë që qëndron e hapur. A do të merrni masa në sanimin e asaj pusete?...

Merisa Sharku: Përsëritet për të gjithë! Para disa muajsh po në këtë foltore erdh një fjalim me tone goxha të larta dhe me fjalë të inatosura "Na kemi diçka, por jo si ju, për inat të juajin" Dikush po harron që qëllimi i vetëm këtu është të punohet për të mirën e vendit. Tashmë është e dëshmuar që secili projekt i hartuar, e i implementuar nga komuna po bëhet "shkel e shko". Vite më parë, një grup i të rinjve me energji të mirë dhe vullnet të plotë për të bërë e për t'i dhuruar një imazh të bukur Rahovecit, ideuan një ikonë të kthyer në "brand" të quajtur "Grapeland". Në atë kohë, grupi entuziast i drejtohen zyrës së kryetarit për ndihmë në implementim. Në këtë rast kryetari kërkon nga grupi që projekti t'i dorëzohet atij, e ai të bëjë çfarë të don me të. Grupi normal që nuk pranoi. Kryetari i ka pëlqyer ideja tepër, kjo shihet në projektin e prezantuar para disa dite nga vetë kryetari. Që mos t'i akuzojmë për plagjiatur, shkojnë e bëjnë verzionin më të keq të mundshëm të kopjashës. Prej një projekti kaq madhështor e fokus primar në gërma gjigande, jepet një verzion i një shkrimi minuatuar. Prej një platoje të mirëmennduar posht rrugës, në një ballkon panoramik të rrezikshëm mbi breg. Për mos t'i përmendur detajisht defektet e projektit, haku i kohës po i lë për një rast tjetër defektet e projektit. Pos asesi nuk mund ta lë ndryshimin e emrit nga Grapeland në Grapecity dhe me të vërtetë duhet të kesh shumë inate që ta bësh këtë gjë. Nga kjo foltore shfrytëzoj rastin të bëjë thirrje për ekzekutivin: Ju lutem rishtyrtojeni projektin, kthehuni në idenë fillestare. Implementojeni projektin fillestar ashtu siç i ka hije. Mos e hudhni posht të gjithë atë mund të grupit ideues dhe entuziazmin e të gjithë atyre qytetarëve. Ju lutet, aty mund të bëhet një monument që do të përcjellë breza të tërë. Mos ja humbisni këtë shansë Rahovecit. Qështja tjetër bazohet në një reagim timin para disa dite, ka të bëjë me çerdhet. Pozita ime në këtë sallë është këshilltare komunale. Pra, unë si këshilltare e këshilloj vetëm ekzekutivin e komunës sime dhe nuk mund të jap këshilla në Malishevë sepse atje nuk dëgjojnë. Atje veç mund ta marrë ndonjë llaf dhe një prej llafeve që kam dëgjuar është që ata vetë i kanë inventarizuar çerdhet. Pra, unë nuk mund ta këshilloj ministren e arsimit, sepse ende nuk jam bërë këshilltare e saj, mund ta këshilloj vetëm Komunën e Rahovecit që t'i inventarizoj tri çerdhet e ndërtuara prej saj (Krushë, Ratkoc, Xërxë). Sigurisht, pas kësaj këshille unë me kolegë shkojmë çerdhe në Xërxë edhe pse e pafunksionalizuar dhe e mbyllur. Përkundër kësaj, ne hymë brenda falë derës së dëmtuar dhe për fat të mirë atë ditë nuk kishte frymë, sepse prej frymës morëm vesh që hapen edhe dritaret. Kualiteti ka qenë shumë i dobët, me apo pa presionin tonë inventari do të sigurohet. Por, si do t'ja bëjmë me kualitetin tepër të dobët të këtyre çerdheve?!

Kryetari: Besoj që kryesuesi e ka parasysh faktin që rregullorja duhet të zbatohet. Kualifikime se a e zgjas unë fjalën një orë a po një e gjysmë, për një temë që Ilir Pallqës as që i intereson "amo bash hiç". Nuk është çështje e tij që t'ia tregojë detyrat kryetarit. E respektoj shumë shqetësimin që e paraqiti Fahrija, sepse ky është edhe shqetësim i imi dhe i qytetarëve. Thash që përgjigje nuk do të merrni sot dhe ju kisha lutur që t'i bëni pyetjet e arsyeshme. Kryetari i komunës e ka fituar mandatin me ekipin dhe planin e vet dhe kur t'i fiton ndokush zgjedhjet, le t'i bëjnë planet e veta. Unë jam kompetent për një projekt të mirë, apo jo të mirë, për një ide fantastike apo një ide të shëmtuar. Abstolutisht, këtu jam për punë të mira dhe më vie mirë që komuna jonë është më e mira në Republikën e Kosovës. Më të mirët në performancë dhe transparencë që edhe mbi 1.645.000€ i kemi fituar me meritë. A bëj presion apo vërejte unë te qeveria apo jo, përgjegjësia është e Smajl Latifit dhe të jeni të bindur të gjithë që unë e di çfarë vërejtje bëj. "Shyqyr" që po i dhemb dikujt fjala ime publike, nëse nuk i dhemb atëherë është keq. Do t'i dhemb çdo herë atyre që nuk janë në tokë të bukës, secilit, në nivel lokal apo qëndror. Unë jam kryetar i komunës dhe kam mandat që ta bëj përzgjedhjen e projekteve. Nuk e kam anashkaluar askënd, mirëpo me "hajgaraxhi" unë nuk kam punë. Përndryshe, i kërkoj kryesuesit në çoftëse është e shkruar diku në rregullore që prej seancës të përjashtohet ai që mendon që e ka foltoren dhe mund të flas "çkamos". Unë jam kryetar i një komune,

e cila është më e mira në nivel të Kosovës. Këtë nuk po e them unë, por qeveria e Republikës së Kosovës, të cilën do ta kisha rrëzuar dje, jo sot.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit shumë i nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, kolegë, media, përfaqësues të KFOR-it, qytetarë që po na përcjellni. Kryetar, nëse shqetësimet e qytetarëve që po shfaqen në këtë foltore, të duken shaka, atëherë shakagji jeni ju. The që për kursimin e kohës nuk doni të përgjigjeni, a ka mundësi të më tregoni se çfarë pune po bëni tjetër?... Në këtë pikë lejohen diskutimet, sepse kryetari i komunës foli 40 minuta sikur me qenë komandant i stacionit të policisë, për shqetësimet që edhe ne pajtohemi për çështjen e grabitjeve në Komunë të Rahovecit. Duhet t'i dëgjoni kritikën e anëtarëve të kuvendit, sepse ne jemi përfaqësues të qytetarëve që edhe ligji e parasheh mënyrën e shfaqjes së problemeve në komunë dhe ju t'i rregulloni ato. Por ju nuk i rregulloni. Atëherë kështu, kryetari ka filluar që diskutimet t'i bëj politikisht, ndoshta për shkak të afrimit të zgjedhjeve nacionale. Kryetari i komunës po punon shumë, por politikisht. Duke filluar prej bursave në vlerë prej 50€, kubëzave, asfaltit e deri te projektet milionshe po shfrytëzohen politikisht për vota, këtë e dinë të gjithë. Dua të ritheksoj që kam qejf ende të besoj që respekti për vlerat e luftës është i singertë, por kjo nuk mjafton. Jemi në vitin 2024 dhe prej institucioneve kërkohet një standart tjetër i punës, jo ky i qeverisjes Latifi. Gjithashtu puna juaj nuk ka mjaftuar asnjëherë, sepse nuk është pa kurrë dhe nuk po preket ende prej banorëve tanë. Mungesa e vullnetit të mirë ka rezultuar pa sukses në punën e Aleancës për tërë këto vite qeverisje, ku sot janë qytetarët ata që po e paguajnë çmimin. Asnjë çerdhe e re funksionale për tërë këto vite qeverisje edhe pse janë premtuar 4 të tilla qysh në vitin 2017. Po nga ai vit, prioritet ka qenë agro-turizmi, por asnjë investim në këtë drejtim. Subvencione pa hesape dhe pa asnjë rezultat. Mjete bujqësore ndër vite dhe pa e ngritur sado pak bujqësinë ose sipërfaqet e mbjellura. Bujqësia në Rahovec është në luftë për mbijetesë e punëtorëve të zellshëm të këtij sektori. Ende një pjesë e pajisjeve të dhëna që shfrytëzohen nga bujqit nuk i janë paguar operatorëve ekonomikë. Subvencionimi politikë i klubeve që u shuan ose rrezikojnë të shuhën, besa edhe me zyrtarë komunalë në borde të tyre, përgjegjësi nuk ka sepse ju nuk keni ndjenja për sport. Një qeverisje pa plan, pa ide, pa kreativitet, aktivitetet solemne pa sharm, festat zyrtare pa gëzim. Besa edhe vendimet për themelimin e këshillave organizuese janë shabllon, nuk ka risi, nuk po ecni me kohën, keni mbetë larg, larg. E keni mësuar formën t'i fitoni zgjedhjet, por nuk po mësoheni të udhëheqni drejt edhe pas shumë viteve pushtet. Keni ardhur të uritur, por nuk po iu mjafton. Do të shkoni të uritur, por me barkun plot. Do të mbaheni mend shumë gjatë për dëmin që e keni shkaktuar dhe padrejtësitë që i keni bërë dhe për shembullin jo të mirë të qeverisjes. Qytetarë të Komunës së Rahovecit, kryetari do të kandidojë për deputet. Ka ble edhe banesë në Prishtinë. Po dëshiron të jetojë atje, mbase është një vend më i mirë për të jetuar, teksa në që jemi këtu duhet të mendojmë më mirë dhe më gjatë për zhvillimin e komunës sonë. Mendoni mirë para se të zgjidhni, sepse jo gjithkush mund të krijoj zgjidhje për Komunën e Rahovecit.

Kryetari: Kryesues i kuvendit të komunës, besoj që nuk është pika e raportit 6-mujor, e as pika raportit vjetor të punës. Nëse fushata për dikë ka filluar, unë jam në fushatë prej vitit 1989 dhe kurrë nuk ndalna. Ju lutem, kualifikimet dhe fyerjet është mirë t'i hiqni përfundimisht. Unë jam njeri që kam integritet, kredibilitet, konceptin tim dhe parimet e mia. Unë nuk e kam problem a jam apo jo kryetar. Një problem e kam që kjo qasje e poshtër e ulët, e dikujt këtu në këtë sallë... bile kërkoj që kryesuesi ta përdorë rregulloret dhe ta përjashtojë. Unë si kryetar i komunës kërkoj të përjashtohet gjuha e poshtër dhe fyese që përdoret në këtë sallë. Kjo gjuhë e ulët, e poshtër dhe fyese nga një djalë i ri, nuk nënkupton që ky lloj i riu me këtë lloj profili ka ndonjë prespektivë. Ju siguroj këtu që konceptet dhe fjalitë që dëgjohen këtu, as deri te "rrasat" e Rahovecit nuk shkojnë. Prandaj, shfrytëzimi i foltores duke e keqpërdorur nga një i zgjedhur ndaj një të zgjedhuri me gjuhë personale, nuk është i mirë. Thash, shakatë si këto i fus" në gjepin e vogël të këmbës së majtë". Ky është pasqyrim i gjuhës së urrejtjes ndaj një individi nga një individ dhe është e papranueshme në komunën tonë dhe në Republikën e Kosovës. Sapo folëm për njerëz që kemi pasur dallime politike dhe i kemi organizuar në formë respekti komemoracion. Unë jam njeri institucionalist dhe jam pro kritikës politike, por jo me gjuhë dhe fjalë të cilat unë as Putinit s'ja them. Thash që në fushatë jam që nga koha kur jam bërë të dij dhe jam në shërbim të qytetarëve, ndërsa ti me këtë qasje, kurrë zgjedhjet nuk do t'i fitosh.

Sinan Kryeziu: Konsideroj që me bë zhurmuesin brenda në sallë është shumë lehtë. Ne jemi këtu të ballafaqohemi me argumentet tona dhe me atë që pretendojmë që është e drejtë. U fol për çerdhet që janë investuar në komunën tonë, konkretisht për inventarin. Ilirit meqë e kam dost, ia dërgova kontratën në facebook. Kontrata është e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit dhe DKA-së, për ta siguruar inventarin. Kur jemi te lidhja e kontratës, Ministria duhet ta ketë të qartë nëse investon në inventar, që paratë nuk janë të Ministres Nagavci dhe të Albin Kurtit. Këto janë

taksa të qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilat kthehen në shërbim të fëmijëve (t'i dërgojmë në kopsht). Nga ish kolegu im, Defrim Kafexhiu u tha që kryetari po bën fushatë, po shtron kubëza dhe po bën rrugë... Më vie keq për vetëqeverisjen lokale, kjo është bërë për shërbimin më të lehtë të qytetarëve apo bartja e kompetencave nga niveli qendror në nivelin lokal. Në këtë rast kryetari hyn në garë me një program politik dhe fiton. Nuk ka vepër penale këtu që ekzekutivi të m'a shtrojë rrugën. Në momentin që nuk bëhen këto rrugë dhe ky ndriçim, këto çerdhe, shkolla në Xërxë 1.5 milion€, për zotin në zgjedhjet e ardhshme ky nuk merr votë, sepse ndëshkohet dhe në këtë rast fiton dikush tjetër që e ka një ofertë më të mirë për qytetarët.

Shqipe Kryeziu: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Kryesues, pikërisht e kam drejtpërdrejt me juve. A ka mundësi të shikohet mundësia që të mbahet ndonjë trajnim për këshilltarët komunalë. Ne që jemi në kuvendin komunal që ta mësojmë rregulloren dhe mos të kemi nevojë që ta lexojmë më. T'i dallojmë pyetjet, diskutimet dhe gjërat tjera.

Sejfullah Sejfullahu: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Pasi i "rrehëm" krejt temat me komente e deklarata, të kalojmë pak edhe te dinari dhe do të ishte mire që ta heqim këngën "Qikën e kojshisë me një dinarë e gjysmë, e kam begenisë" E dyta, para 2 ose 3 seancave e kemi diskutuar që ta vendosim një pikë të rendit të ditës për komente. Do të ishte mire që ta aprovojmë si pikë të rendit të ditës. Pyetjet e mia janë kështu, për drejtorin e Shëbimeve Publike: Ai tipi që po i bjen lopët në Krushë, a ka kontratë me komunën t'i mbajë lopët në aty vazhdimisht, apo është pa kontratë? Përkundër asaj që ne i themi që t'i largojë, ai po kthehet përsëri. I bie si të jetë diçka personale me të dhe ka mundësi që të inatoset me mua. Kërkesa e dytë: Ne më datë 26, e dini që e kemi promovimin e muzeut. Përmes postimeve të juaja e kam parë që i keni pastruar deponitë, mirëpo është mirë që deponinë të ne ta pastroni edhe njëherë.

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të kuvendit, pas një pauze që bëmë prej 5 minutave, vazhdojmë...

Ilir Pallqa: Faleminderit kryesues! I nderuar kryesues, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, të pranishëm të tjerë në sallë. Kundërshtarë të vegjël, kundërshtarë të mëdhenj, gojën plot - thuajse punët top, flamuri kuq – flamuri zi. Një vajzë e cila ndodhet në këtë kuvend, e emëruar nga kryetari si asambleiste, për nga legjitimiteti kah fundi i listës, ka folur për kundërshtarët e kryetarit. E nxitur nga ai kuptohet, se ajo punon edhe në zyre të kryetarit. Në anën tjetër Smajl Latifi flet dhe cilëson si "kundërshtarë të vegjël" ata që edhe pse në opozitë, kanë si ai në çështjen ekzekutive për nga vlera e projekteve të komunës. Ne nuk jemi "kundërshtarë të vegjël", as të mëdhenj të kryetarit të komunës. Ne jemi argatë të komunës. Ndoshta jemi kundërshtarë politikë të Smajl Latifit, të vegjël sipas tij, por Smajl Latifi është kundërshtar i kryetarit të komunës, kundërshtar i madh. Kryetari i komunës, në përvjetorin e Pavarësisë do të donte të kishte gjallëri, festë, e jo njerëz të po këtij institucioni të shkojnë në shqipëri e vende të tjera për përvjetor të Pavarësisë. Organizimet pos që janë të varfura, në shumë raste janë qesharake. Buxheti që po ndahet për organizime është i papërfillshëm, prandaj po dalim qesharak. Përveç buxhetit, duhet të ketë edhe kreativitet dhe kjo gjë mungon në ekzekutiv. Nuk e di a ka pasur ndonjëherë, ndoshta edhe po, dikur shumë moti kur nuk ishte Smajli kryetar. Si fëmijë dilsha në qendër e në park, kohëpaskohe në organizime. Në atë botë ishin më interesante, kam luajtur si aktor edhe vetë. Tani ka më pak njerëz dhe më pak kreativë, më pak njerëz dhe më shumë mendë biznesorë. 17 Shkurti i Pavarësisë kujtohet me qetësi si ditë e rëndomtë, me seancë solemne dhe pa organizim. Sot është një ditë e ngjashme, jo për nga rëndësia e as për nga fjalimet, por nga personat që po marrin pjesë në kuvend dhe për nga fytyrat e paimnteruesura të këtyre personave për zhvillim dhe organizim. Organizimi si kujtim ka kosto financiare, kosto kohore dhe energji trupore. Po ndalem te turneu te palestra, "aty pak t'ja kish msy LDK-ja, e kish fitu". Nuk bëhet turneu me 7-8 ekipe. Sa shkolla i ka komuna? Secila shkollë ta bëjë nga një ekip, plus grupe të tjera, disa parti dhe i kalon 20 ekipe dhe realizohet ashtu siç i ka hije. Kjo është këshillë për vitin tjetër për përvjetor, kurse pas 2 viteve ju uroj jetë të gjatë dhe të lumtur.

Hasan Përboqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryesues, drejtorë, kolegë, monitorues, media dhe ju bashkëqytetarë. Në fakt, e mora fjalën prej kryesuesit ashtu siç e kam kërkuar prej fillimit të mandatit, 2 vite e gjysmë më herët gjatë tërë kohës. Kryesuesi është i zgjedhur prej asambleistëve dhe kërkoj që t'i mbrojë asambleistat. Siç kam reaguar më herët edhe këtë herë reagoj në emër të grupit që të ndalet gjuha ofenduese ndaj asambleistëve. Asnjë asambleistë nuk ka të drejtë të thotë që "unë jam më i votuar, ky është më pak i votuar", sepse të gjithë këtu jemi të barabartë. Shembull e kemi për moment Ferizin, si asambleist më të votuar, por asnjë privilegj nuk e ka më shumë sesa një asambleist që ka më pak vota. Për këtë arsye kisha kërkuar që të ndalen ofendimet. Po e ripërsëris kryesues, ofroi mbështetje asambleistëve, mos lejo ofendime.

Drilon Mustafa: Përshëndetje për të gjithë! Më herët e ndërpreva fjalën për shkak të kuorumit, sepse gjysma e asambleistëve nuk ishin në sallë. Secili nga ne paguhemi 560€ prej taksa të qytetarëve. Mendoj që nuk është normale dhe serioze të dalim në foltore, të flasim dy minuta dhe ta lëshojmë sallën. Ne e përfaqësojmë interesin e qytetarëve këtu dhe sigurisht që duhet të bëjmë pyetje dhe zgjidhje. Jemi këshilltarë komunalë, duhet ta këshillojmë edhe kryetarin dhe të gjithë. Ju lus të gjithëve që ta respektojmë punën që e kemi. Një punëtor i imi ndoshta e ka pagën më të vogël sesa ne ktu që vijmë një herë në muaj. Nuk e di për seancën e Pavarësisë a kanë marrë pjesë 12 ose 13 asambleistë, si dhe për ngjarje të tjera që i fton komuna. Nëse ju pengon kryetari, ju fton institucioni. Shumica prej juve nuk merrni pjesë. Vërejtje kolegjiale. Pyetja ime është për drejtoreshën e Inspektoriatit: Kohëve të fundit po i shohim disa pastrime të mbetjeve, esenca është që gjithçka që po shtyhet, pas 2-3 muajve po n'a kthehet. Propozoj që nëpër deponitë ilegale të vendosim nga një kamerë. Kam hulumtur dhe një kamerë me një shtyllë kushton 350-500€ dhe d.m.th neve në çdo tre muaj po na kushton kjo shumë e shpenzimeve dhe sigurisht të dënohen ata që e ndotin ambientin.

Dafina Gashi: Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, media, të pranishëm në sallë. Po e bëj një replikë të shkurtër që ta qartësoj një send, kryetari nuk më ka emëruar si asambleiste, si kandidate për asambleiste, po. Qytetarët janë ata që m'a kanë besuar votën, njëjtë sikur që ua kanë besuar edhe këtyre këtu. Nuk më bën mua më të pavlefshme si asambleiste, fakti që këta kanë hyrë si asambleistë prej fillimit.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë anëtarë të kuvendit. Deshta ta shfrytëzoj të drejtën e replikës që më herë m'u mohua prej kryesuesit. Meqë kryetari nuk është këtu, fillimisht hezitova, por më mirë le të jetë dhe të dëgjohet publikisht. Kryetari nuk mund ta determinojë formën e të folurit, të diskutimit apo përpilimit të pyetjeve kundrejt ekzekutivit. Ne secili jemi të zgjedhur. Kryetari shpeshherë edhe na injoron duke thënë që "ka këtu disa që e kanë një grusht vota". Pavarësisht kësaj, ne jemi përfaqësues dhe të zgjedhur të qytetarëve në këtë kuvend. Forma e të bërit politikë determinohet nga ne dhe jo nga kryetari i komunës. Në çoftëse kryetari nuk pajtohet me diskutimet që ne i bëjmë, atëherë ky nuk është problemi ynë. Neve shumë punë të kryetarit nuk na pëlqejnë, por ai e ka pushtetin dhe vazhdon me formën e tij të punës. Ne jemi këtu që t'i përballim idetë tona dhe të bëjmë politikë në kuvend. Gjërat që kryetari po tenton që t'i kalojë në personale është e padrejtë. Këtu bëhet politikë dhe në këtë formë secili prej nesh mendojmë të vazhdojmë përpara.

Ilir Pallqa: Faleminderit kryesues! Propozimin e Drilonit ne e përkrahim. Kurse për kolegen, unë nuk të kam ofenduar, kam konstatuar që je kah fundi i listës. Për emërim, ne e dimë që nuk emërohet në atë mënyrë, por e dimë që një vajzë para kësaj ka qenë në radhë për të hyrë në asamble, ajo është punësuar sipas negociatave politike dhe pastaj ka ardhur e nderuara.

Sejfullah Sejfullahu: Faleminderit kryesues, nënkryetar, të pranishëm! Nuk e kam shprehur të replikoj, por doja të pajtohem dhe pak ta plotësoj atë që tha shoku im, Driloni. Është shumë e vërtetë dhe me vend që ne nuk po mblidhemi në tubime të pavarësisë. Mendoj që nuk është mirë të mungojë askush. Për kritika jemi të gjithë, por kritikën më të madhe e keni ju, ia kam thënë privatisht mikut tim, drejtorit Afrim Dina. Është paksa edhe fyese që në këshillin organizativ nuk ka pasur asnjë të opozitës. Përkundër kësaj, drejtori 24 orë është në terren, por këto gjera nuk e di kush i vendosë. Pajtohem edhe me Burimin që kësaj here festa e pavarësisë nuk ka qenë e organizuar ashtu siç i ka hije.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Një replikë të vogël me Iliri. Ilir, ne e kemi lënë shkakun i simbolikës, se përndryshe turneun do ta fitonim pa telashe. LDK-ja kur ia "msyn" edhe fiton. Drejtor, ndërkohë nëse ka mundësi një informatë, për stadiumin e qytetit të Rahovecit. Ne e kemi pa si shqetësuese, dikush si propagandë politike. Megjithatë, stadiumi do të rrënohet për shkak të sheshit. Kërkesa jonë e vazhdueshme ka qenë që mos të rrënohet, pa u bërë një zgjidhje së paku për stërvitje për KF. Rahovecin. Ta kemi një informatë se si po planifikohet saktësisht të ndodh kjo çështje. A do të ketë një fushë shtesë, para se të prishet stadiumi apo stadiumi do të prishet dhe fusha shtesë do të ndërtohet kur ti vie rendi. Po flas gjithmonë për stërvitje, se për ndeshje e kemi të qartë këtë punë që është në projekt stadiumi kryesor i qytetit të Rahovecit.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit kryesues! Meqenëse i kam dhënë kritikën e mia rreth kompleksit sportiv, dua ta përgëzoj ekzekutivin për punën e përshpejtuar që po bëhet atje nga kompania kontraktuese. Kjo është një gjë e mirë dhe besoj që sa më shpejt do të përfundojë.

Nënkryetari: Faleminderit i nderuar kryesues, të nderuar kuvendarë. Kam qenë këshilltar komunal më herët, me Burimin edhe me disa prej kolegëve këtu. Ajo që sinjorisht kisha kërkuar nga ju, jo nga pozita e nënkryetari, më

tepër si Fatmir është të jeni më përbajtësor dhe më kreativ. Në fund, zgjedhjet vinë përsëri dhe ai që i fiton zgjedhjet ia shtrini dorën, në këtë rast kryetarit edhe për një mandat tjetër. Një përgjigje të shkurtë për Burimin, sipas informatave që i kam, ndeshja e futbollit do të zhvillohet në stadium, të shtunën në ora 13:00. Rreth ndërtimit të stadiumit edhe ne jemi me ju dhe shpresojmë që do të rregullohen të gjitha procedurat që kërkohen që dihet tashmë lokacioni publikisht, tek Stone Castle.

3. Shqyrtimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.325/22, i datës 31.5.2022, për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim;

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të kuvendit, para jush e kemi vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.325/22. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr.325/22 i datës 31.05.2022, për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim. Pika 3.4 e vendimit bazim ndryshohet dhe formulohet me tekstin si në vijim: Emërohet një antar i komitetit nga radhët e PDK-së dhe përbërja tjetër mbetet e njëjtë, Alban Bajraktari, Leonard Morina, Fahrije Lushi, Xhevdet Morina (ekspert i jashtëm). Cili është propozimi nga PDK-ja për këtë komitet?...

Bejtullah Bejtullahu: Faleminderit i nderuar kryesues! PDK-ja e propozon Sejfullah Sejfullahun.

Kryesuesi: Faleminderit! Atëherë komitetit i shtohet Sejfullah Sejfullahu.

Dafina Gashi: Faleminderit kryesues! Para se ta votojmë këtë pikë të rendit të ditës, unë nuk e kam pranuar ende një përgjigje në pyetjen që e kam parashtruar në seancën e kaluar, në lidhje me atë se pse nuk ka qenë funksional ky komitet gjatë tërë vitit 2023.

Shqipe Kryeziu: Faleminderit kryesues! Nuk e di nëse jeni konsultuar mirë me zyrën ligjore, por a duhet të respektohet kuota gjinore edhe këtu?

Fahrije Lushi: Faleminderit kryesues! Ne nuk e kemi organizuar asnjë takim në shkollë ashtu siç e kemi hartuar planin, sepse kemi qenë të pakompletuar si komitet.

Nënkryetari: Rregulli e kërkon edhe respektimin e kuotës gjinore. Të jeni të bindur që 99.99% do të kthehet ky vendim nëse do të kemi zëvendësim si në këtë rast, gjinia femërore me atë mashkullore.

Sejfullah Sejfullahu: Unë nuk kam qejf të kthehet një vendim shkaku im, kështu që unë po tërhiqem, sepse nuk kam i gatshëm ta ndërroj gjininë. Partia Demokratike propozon Melinda Iska Oruqi.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Duke pasur parasysh që i kemi dy të gjinisë femërore dhe tri mashkullore, a kërkohet kuota 50/50? Apo 30%?

Nënkryetari: Ne i kemi pesë anëtarë të emëruar në këtë komitet dhe është Fahrije Lushi LDK, Ellma Hamza PDK, kjo e fundit më nuk është asambleiste dhe me propozim që Sejfullah Sejfullahu me qenë anëtar i këtij komiteti, pas votave të kuvendarëve. Në këtë rast do të kemi 4 meshkuj dhe një femër.

Burim Krasniqi: Kërkoj falje, Melinda Iska meqenëse është anëtare e KPF-së, nuk ka të drejtë të jetë. PDK momentalisht nuk ka përfaqësues tjetër të gjinisë femërore. Kërkoj mirëkuptimin e ekzekutivit të rishikojnë vendimin dhe le të jetë Sejfullah Sejfullahu prej PDK-së, le të ndërrohet përfaqësuesi i jashtëm me një të gjinisë femërore. Është jokorrekte në raport me PDK-në që nëse nuk ka përfaqësues, të tentojmë ne si parti tjera. Nuk pajtohem, sepse është jokorrekte. Vendoseni në votim me 4 emra: Alban Bajraktari, Leonard Morina, Fahrije Lushi, Sejfullah Sejfullahu dhe që eksperti i jashtëm të caktohet i gjinisë femërore nga ekzekutivi.

Leonard Morina: Faleminderit kryesues! Përsëritet për nënkryetarin, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit. Sa i përket përqindjes, kemi qenë 2 me 3 dhe nuk i bie 50/50. Atëherë unë jam në KPF dhe gjithashtu jam anëtar i Komitetit për Arsim. Propozoj që të jetë Melinda, në çiftëse ata e kthejnë të jashtëligjshme, atëherë edhe unë duhet të tërhiqem prej Komitetit për Arsim.

Shqipe Kryeziu: Sa e kuptova që PDK-ja e propozoi Sefën dhe mbetet Sefa. Me gjithë respektin për Melindën, qenka në KPF, gjithashtu edhe unë jam në KPF dhe dëgjova që nuk lejohet.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Përsëritet për të gjithë! I nderuar kryesues, në mungesë të asaj që nuk kemi femër tjetër në parti, meqë Melinda nuk bën të emërohet sepse qenka në KPF. Ne e kemi propozuar Sefën dhe Sefa mbetet prej PDK-së. Në çiftëse ata e kthejnë të jashtëligjshme, i ftoj partitë e tjera të bëjnë zgjidhje ose ai eksperti i jashtëm mund të ndërrohet me një femër. Ne e duam Sefën aty dhe pikë, sepse e drejtë e PDK-së është që ta ketë një anëtar aty.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit kryesues! Grupi parlamentar i PDK-së ka shumë të drejtë. Udhëzimi administrativ 05 të vitit 2020, thotë: Përbërja dhe funksionimi i komiteteve tjera përcaktohet me nen të veçantë

dhe nuk përcaktohet aty barazia gjinore, sikur në komitetet obligative. Kemi të drejtë që kuvendi të ketë përfaqësim të partive politike në komitet dhe të kuota e barazisë gjinore nuk ka problem.

Isak Hoti: Faleminderit kryesues, nënkryetar! Ligji për barazi gjinore e thotë decidivisht që kuota duhet të jetë 50/50. “Ju mund ta tjerri sit ë doni” Në çoftëse një vendim shkon në MAPL, në këto raste komitete janë tek për nga numri i anëtarëve, përderisa janë tek, e kemi pasur mundësinë të jenë 2 me 3. Por nëse e bëjmë 4 me 1, atëherë do ta kthejnë. Gjithashtu është e kundërligjshme nëse dikush është anëtar në dy komitete dhe duhet të ndërrohet vendimi sa më shpejt.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Kërkoj mirëkuptimin, ne nuk jemi “t’u tjerri” asgjë këtu! Zyrtari ligjor na jep ndihmë juridike dhe nuk na tregon a jemi duhe e “tjerrë”, apo jo! E dyta, bisedoni me Leonardin dhe me ata, nëse kanë vullnet që mos të kthehet edhe një herë vendimi, ta dërgoni një përfaqësuese femër në këtë komitet prej VV-së dhe të ruhet kuota. Më pas ta nxjerrim një vendim të ri që e propozoi edhe zyrtari ligjor dhe ta shfuqizojmë vendimin aktual. Besoj që në këtë rast nuk do të vimë në një situatë ku do të na kthehet vendimi.

Isak Hoti: Te Udhëzimi Administrativ për përzgjedhjen e komiteteve: Neni 14, pika 3: Anëtarët e komiteteve tjera nuk kanë të drejtë të jenë më shumë se sa në një komitet.

Bejtullah Deliu: Mendoj që po debatohet pak më shumë se që duhet për këtë pikë. Këtu duhet një vullnet i mirë nga subjektet politike dhe konkretisht dihet që PDK-ja të ketë përfaqësues aty. Është edhe një opsion që e dha zyrtari ligjor që të votohet nga fillimi dhe nga fillimi mund të ceken të njëjtët emra, por vetëm të ndryshohet gjinia tek eksperti i jashtëm.

Leonard Morina: Unë jam i gatshëm të tërhiqem. Por edhe Merisa Sharku është në Komitet për Komunitete, Vlora është në Komitetin për Shëndetësi. Kështu që ne nuk kemi zgjidhje, e vetmja zgjidhje është të eksperti i jashtëm edhe pse po më vie keq.

Feriz Thaqi: Përshëndetje kryesues! PDK-ja e ka propozuar Sejfullah Sejfullahun dhe është mirë ta votojmë.

Kryesuesi: Faleminderit! Atëherë, këtë plotësim-ndryshim e kalojmë në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht votohet kjo pikë e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.174/23, i datës 27.12.2023, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2024;

Nënkryetari: Faleminderit kryesues! Të nderuar kuvendarë, në mungesë të drejtoreshës për Shëndetësi, po e prezantoj shfuqizimin këtij vendimi. Tash e 10 vjet, për çdo vit kuvendet i kanë pasur vendimet për mbulimin e shpenzimeve të varrimit. Kësaj here vendimin 01 Nr.174/23 të datës 27 dhjetor 2023 për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2024 duhet ta shfuqizojmë, sepse kështu e kërkojnë nga ministria e linjës. Arsyeja e shfuqizimit është që duhet të ndërrohet kodi buxhetor, prej mallrave dhe shërbimeve që është aktualisht, duhet të vendoset në subvencione përmes formatit të thirrjes publike. Në KPF është kërkuar numri i vjekjeve dhe përafërsisht sa ka qenë vlera e mbulimit. Në bazë të Drejtorisë së Administratës 263 vdekje (mund të mos jenë të gjitha të regjistruara) dhe në bazë të raportit vjetor financiar 2023, shuma për mbulimin e shpenzimeve të varrimit ka qenë 79.100€.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Dëshiroj ta pyes nënkryetarin se në çastin kur e kemi marrur këtë vendim (27.12.2023), a ka ndryshuar tani ligji? Apo ka qenë i njejtë edhe në momentin kur e kemi marrur vendimin? Shtrohet pyetje: Nëse ka qenë ligji i njejtë, pse nuk shqyrtohet mirë këto dokumente dhe mos të na kthehen në këtë mënyrë. Nuk është në rregull kjo punë. Vendimet duhet t’i shqyrtojmë me kohë, para se kuvendi të vendosë.

Burim Krasniqi: Nënkryetar, prej Asociacionit të Komunave të Kosovës, a keni informatë nëse iu ka kthyer ky vendim të gjitha komunave, apo vetëm Rahovecit? Sepse të gjitha komunat e kanë këtë formë të financimit të shpenzimeve të varrimit.

Leonard Morina: Përveç asaj që tha Burimi dhe Baca Fazli, unë e kam një pyetje shtesë: Çka do të ndodh me rastet që janë tani, a shfuqizohet ky vendim dhe më nuk subvencionohen varrimet? Apo deri sa të vjen ligji i ri, do të vazhdoni me të vjetrin.

Nënkryetari: Nuk kam informatë se si kanë vepruar komunat tjera. Në kuptimin e financave kanë ndryshuar programet buxhetore dhe për vitin 2024 kërkohet me qenë prej kategorisë së subvencioneve. Te Leonardi: Pas

shfuqizimit të këtij vendimi, do të jetë thirrja publike për aplikim dhe t'i kryejmë sa më mirë këto shërbime të varrimit.

Burim Krasniqi: Nënkyetar, procedurat e tenderimit marrin një periudhë kohore të caktuar. Kërkoj mirëkuptimin që zyra e kryetarit ka një buxhet të caktuar. Deri në 2000€ lejohet subvencionimi direkt dhe kërkesë e jona si LDK është që procedurat e varrimit që ndodhin deri në lidhjen e kontrate të re, të mbulohen përmes zyrës së kryetarit me subvencionim.

Nënkyetari: Në secilën formë që do të veprojmë karshi vendimeve të varrimit, do të jemi të gatshëm. Procedurë të tenderimit nuk do të ketë, sepse është kategori e subvencioneve dhe ne mundemi që në thirrje publike të evidentohen edhe pagesat retroaktive prej 1 janarit 2024.

Burim Krasniqi: Unë e kuptoj komplet vullnetin e ekzekutivit që Bashkësia Islame t'i kryen ceremonitë e varrimit, ashtu siç i ka bërë deri tani. Megjithatë ju do ta bëni një thirrje dhe do ta kenë të drejtën e barabartë të gjithë që kanë shprehur interesim për ta bërë këtë procedurë. Në momentin që thua “të kthehen në retroaktive” nuk lejohet ligjërisht të paragjykohet se kush do ta marr atë të drejtë të ofrimit të shërbimeve. Në këtë kuptim, zyra e kryetarit e ka një buxhet. Lus Zotin që mos të ketë asnjë vdekje deri sa të lidhet kjo marrëveshje, por nëse ka, atëherë, përmes subvencionit nga zyra e kryetarit t'i ndahet Bashkësisë Islame, apo familjes direkt për secilin rast veç e veç.

Nënkyetari: Besoj që kjo zgjidhja e fundit dhe kryetari nuk do ta refuzojë në asnjë mënyrë, deri sa rregullohet çështja tjetër.

Hasan Përboqi: Faleminderit kryesues! Unë nga këndvështrimi im dhe në emër të grupit po e shoh që kjo pikë kuvendin e ka vendosë para aktik të kryer. Pse? MAPL thotë duhet ta shfuqizojmë se është joligjore. Nëse ne si kuvend nuk e shfuqizojmë sot këtë pikë, atëherë ekzekutivi vihet në mes të dy zjarreve. Në një anë, ekzekutivi nuk mund t'i lë anash mbulimet e shpenzimeve të varrimit dhe në anën tjetër nëse i mbulon shpenzimet sipas këtij vendimi, pasqyrat financiare të auditimit dalin të keqklasifikuara 100%. Që mos ta lejojmë të zhagohej më tutje kjo punë, kërkoj që ta shfuqizojmë këtë vendim dhe t'i hapim rrugë ekzekutivit për thirrje të subvencionimit.

Kryesuesi: Faleminderit! Atëherë, e kalojmë në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash votohet kjo pikë e rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i vendimit për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe të shesheve në Komunën e Rahovecit;

Albnor Mullabazi: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, asambleistë. Para jush keni propozimin e komisionit për emërtimet e reja të rrugëve, shesheve, parqeve dhe objekteve komunale. Komisioni është i përbërë prej 5 anëtarëve dhe është i formuar me vendim të kuvendit: Eqrem Spahiu, Nora Boshnjaku, Arbër Zenuni, Ilir Pallqa dhe unë Albnor Mullabazi. Bashkë me anëtarët e komisionit e kemi bërë njoftimin prej dates 21.09.2023 deri 9.10.2023. Janë mbajtur 11 takime me qytetarë. Qëllimi ka qenë që t'iu tregojmë mënyrën e aplikimit për propozimin e një emri për një rrugë, shesh apo park të caktuar. Sipas Ligjit të Sistemit të Adresave, gjatë kësaj kohe kemi pranuar gjithsej 51 kërkesa, prej tyre 8 propozime janë për emërtim të parqeve dhe shesheve, të tjerat janë për rrugë. Para jush i keni 31 propozime për rrugë, ndërsa propozimet tjera kanë qenë në kundërshtim me Ligjin për Sistem të Adresave, apo emra të përsëritura. Kërkoj që ta votoni propozimin e komisionit për plotësimin e listës rezervë.

Sejfullah Sejfullahu: Përshëndetje edhe një herë. Në atë listë, nuk e vërejta emrin e Enver Durakut? Si është puna?

Burim Krasniqi: Te vendimi thotë: Plotësimi i listës rezervë! A janë emra rezervë që merret prej listës kur ka nevoj për emërim? Apo janë segmente të caktuara që do të emërohen? Nëse është për segmente të qarta, atëherë pse është vendim “lista rezervë” dhe jo vendim për plotësimin e rrugëve të reja.

Faton Ramadani: Përshëndetje për të gjithë! Dëshiroj ta ngris një çështje sa i përket emërtimit të rrugëve. Mandatin e kaluar 4 vjeçar, asambleja e kaluar e ka pasur një komision për emërtimin e rrugëve dhe një të ankesave. E kanë bërë një punë shumë të madhe sepse ka qenë një listë e stërzgatur me emra. Lista në fjalë ka kaluar nëpër dy

komisione, por asnjëherë nuk ka ardhur në kuvend për votim. Ku kanë ngelur ata emra? Ka pasur disa ndryshime në Ratkoc, Celinë, Krushe etj... Ne si komisioni e di që kemi marrë mëditje.

Bejtullah Deliu: Faleminderit i nderuar kryesues! Po e shfrytëzoj rastin të bëjë një kërkesë në lidhje me këtë çështje. Është një rast, në maj 1998 ka ekzistuar një “Dorë e Zezë” famkeqe që i kanë marrë njerëzit nëpër rrugë, duke i masakruar dhe më pas ne i kemi varrosur. Rasti i parë në Rahovec është Ymer Deliu, 19 maj 1998. Unë e shoh të arsyeshme që pasi është viktimë e “Dorës së Zezë” të gjendjet ndonjë hapësirë për emërtim të ndonjë rruge që të mos harrohet asnjëherë ky emër. Ka qenë varrim dinjitoz. Ka marrë pjesë edhe i ndjeri Sabahajdin Cena dhe të tjerët.

Albnor Mullabazi: Po ia nisi prej Sejfullahut në lidhje me emrin e Enver Durakut. Emri është në listën ekzistuese, një rrugë e mban emrin Enver Duraku. Na i kemi vendosur tebelat, ka ardhë një mixhë bashkë me tabela në komunës. Për shkak të moshës së tij nuk kemi dashur të reagojmë, por realisht, policia është dashur të merret me këtë pjesë. Te Burim Krasniqi, kjo është e vetmja formë për përfshirjen e emrave, përmes listës rezervë. Te propozimi i Bejtullah Deliut, deri më tani nuk kemi pasur propozime me këtë emër, nëse lejohet që brenda kuvendit të propozohet është në rregull. Te Fatoni, nuk kam informata për atë çështje.

Kryetari: Faleminderit! Më nxiti pak Bejtullahu, unë jam “për” dhe patjetër që duhet t’i ndihmojmë komisionit sepse pavarësisht që i zhvillon takimet në terren, nuk është që ka prezencë të njerëzve. Shpresoj që konstatohet në procesverbal një nga emrat e nderuar që e përmende ti. Ju lutem, kushdo që ka emra të tillë, komisioni është funksional. Në vazhdimësi mund t’i japim autorizime komisionit që ta vazhdojë punën e vet, përmes kërkesave me emra të ndryshëm.

Bejtullah Deliu: Faleminderit kryetar! Nuk i di normat apo kriteret që duhet të përcaktohet që të emërtohet ndonjë rrugë. Ky ka qenë bujk dhe nga “Dora e Zezë” është kapur duke punuar. Pas këtij ka raste edhe tjera, por pasiqë është rasti i pare dhe forma se si është ekzekutuar, është mire të merret parasysh. Do të ishte mire, nëse mund ta bëjmë me një votim të thjeshtë këtu.

Ilir Pallqa: Bejtullah, po të përgjigjen sepse kam qenë në komision. Janë disa parakushte, ne kemi ende mandat si komision. Së pari duhet të përcaktohet rruga se ku vendosim ta kemi në emër specifik. Rruga i ka parakushtet që të jetë 100m e gjatë ose t’i ketë minimum 10 shtëpi brenda saj. Pas kësaj, të vendoset një biografi dhe pas biografisë t’i mbledhim nënshkrimet e asaj ane dhe lënda dërgohet në Drejtori të Urbanizmit.

Shqipe Kryeziu: Një pyetje të thjeshtë për komisionin. Nëse nuk është e kënaqur lagjja me emërtimin e rrugës. Ata tani e kanë paraqitur si shqetësim dhe nuk po iu pëlqen emri. A ka gjasa për ndryshim?

Albnor Mullabazi: Faleminderit kryesues! Në fillim, thirrja ka qenë për propozime të reja sepse me ligj të sistemit të adresave dhe në takimet me agjencionin dej më 2029 ata nuk parashihnin ndryshimin e emrave ekzistues, sepse tani ata janë në një projekt për numra të shtëpive – të hyrjeve të banimit dhe nëse bëhet procesi i ndërrimit të emrave mund të priset sistemi i emërtimeve.

Kryetari: Faleminderit! Besoj që është e qartë se nuk ndryshohen emrat. Përveç argumenteve që i dha dejtori është edhe ajo që ne mund ta ndërrojmë këtu, po sistemi nuk e ndërron. Është diçka që është e rregulluar me ligj. Kësaj radhe, ne nuk do të bëjmë përjashtim, por që Bejtullah Deliu t’i drejtohet komisionit menjëherë dhe t’i plotësojë të gjitha kriteret e nevojshme. Në votim e vendosim listën me atë emër, por Bejtullahu jo më larg se nesër t’i fillojë procedurat e nevojshme. Nëse jeni dakord, atëherë jemi në rregull.

Kryesuesi: Faleminderit kryetar! Nëse nuk kemi diskutime të tjera, atëherë me propozimin e Bejtullah Deliut e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë votash votohet pika e pestë e rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për të zhvilluar procedurat e konkurrimit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë personave fizikë dhe juridikë, deri në 25 (njëzet e pesë) vjet, P- 02302-0 dhe 02299-0, ZK- Rahovec.

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë, të nderuar anëtarë të kuvendit. E lus Sekretariatit ta prezantojë ortofoton e parcelave në fjalë. Sipas ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës,

kryetari i komunës ju propozon që të marrim vendim për pëlqim paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për pronën e paluajtshme të komunës deri në 25 vite, personave fizikë dhe juridikë për ushtrimin e veprimtarisë biznesore, respektivisht për vendosjen e panelave solarë, përmes procedurës së shprehjes së interesit. Pronat e paluajtshme të dhënies në shfrytëzim sipas nenit 1 të këtij vendimi janë prona të Komunës së Rahovecit, janë në kufij njëra me tjetrën P-2302-1 (16 ha 25 ari dhe 13m²) dhe P-2299-0 (68 ari e 6 m²). Çmimi fillestar do të jetë 1.5 cent për metër² për muaj, që i bie 2539.78 € në muaj. Realizimi i pagesës me qera fillon pas 36 muajve.

Ilir Pallqa: Faleminderit kryesues! Jemi te një pikë e ndjeshme që reflekton te ata që kanë ndjeshmëri. Jemi te një pikë ku diskutohet prona e komunës, rreth 17 ha të saj. Po diskutohet për një pronë në qytet, ku në diskutimet e fundit kemi konkluduar që mund të bëhet e zhvillohet për bukuri dhe për vizitë. Vendi ynë është treguar shumëherë bujar me prona, pronat të cilat i kemi dhënë e pastaj kemi qajhtë për to dhe vazhdojmë të qajmë si në rastin e pronave të Stone Castle. Sot, komuna grrithet lart – posht për mungesën e dhe nevojën e pronave. Me këtë pikë që është servuar për diskutim dhe votim, po e shohim që gabimet po përsëriten pa emocion për të ardhmen e komunës. Rreth një muaj më parë e kam riaktualizuar një temë, e cila daton dhjetra vite më parë. Kam bërë thirrje për diskutim rreth akumulimit të një pjese me ujë, ku varësisht nga mundësia do të mund të përdoret për rekreacion, sistem të ujitjes dhe ujë të pijes. Unë kam takuar kryetarin në bufe të komunës, nga ai kam marrë gatishmëri. Pas asaj, me drejtorin e Bujqësisë dhe Ekonomisë kemi shkuar për vizitë te vendi i burimeve në Zhdrellë. Aty pashë interesim. Në atë moment vëreja që mund të niset diçka dhe sipas “takatit” i kam bërë dy takime në Ministri të Mjedisit, ku gjithashtu kam parë gatishmëri për marrjen parasysh të kësaj ideje. Po e potencoj, ideja nuk është e imja, daton dhjetra vite më parë. Unë e mora diku në harresë, e vendosa në publik dhe gjeta entuziazëm. Ajo pjesë duhet studiuar me shumë vëmendje, sepse është e gjatë, e madhe dhe ka ndryshime nga pjesa në pjesë. Diku ka gurë që nuk mbajnë ujin, diku dheu është i rrallë, po gjithsesi diku mund të bëhet dhe nëse nuk bëhet, duhet të shikohet për mundësi. Një pjesë e madhe në formë lugine, me burim të fortë të ujit është pjesa që sot po kërkoni ta japim si komunë për 25 vjet. Pjesë që prekë rrjedhjen e burimit, e cila po të mbushej me ujë mund ta përfshijë gjysmën e asaj prone. Pra, po kërkoni që zhvillimin potencial mal në atë pjesë të pasur me ujë ta lini në harresë, që edhe pas kujtimit dikur, ta pamundësoni. Unë besova që kryetari kur shprehi gatishmëri, e ka pasur njëmend, po doli që jo. Mund të them që më preu në besë, por s’po them! Them që e preu në besë zhvillimin e Rahovecit në atë mal. Andaj, kolegë të nderuar, ju lutem mos e votoni këtë vendim pa u bërë paraprakisht një analizë në atë pjesë, pa u caktuar paraprakisht lokacioni në atë pjesë për akumulim të ujit. Ju lutem, t’i ruajmë të paktën këto prona të pasura e të pastudiuara për potencialin e tyre. Të mos i përsërisim nesër të qarat që i kemi sot, si pasojë e të dikurshmes.

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! Kryetari bashkë me zyrën ligjore, i propozon pikën sektorit të drejtorive të bazuar në ligj dhe më pas ta arsyetojmë këtu para juve. Kuvendari ka kërkuar takim, jemi takuar në zyre. Kemi biseduar me minuta të tëra në lidhje me interesimin e shprehur. Ia kam dorëzuar materialin, gjithashtu edhe dje kam komunikuar personalisht me të, pas një ftese publike që kjo pikë mos të votohet. E kam për obligim që para juve dhe para qytetarëve t’ju tregoj se ku gjendjen këto parcela. Është PZhK-ja që tashmë ka marrë miratimin ligjor. Parcelat në fjalë janë të komunës. Në nuk po iu gjuajmë hi syve dhe nuk ka rrjedhë të ujit në këto parcela. Rrjedha e ujit që vazhdon për “Rimnik” që del te Haxhijaha dhe që vazhdon për “Bërnjak” - Bellacërk dhe derdhet te lumi Drini i Bardhë, e ka rrjedhën e vet, certifikatën e vet dhe menaxhohen prej Agjencionit të ujërave, si dhe nuk janë prona të komunës. E lus Sekretarinë që ta prezantojë ortofoton tjetër. Nuk ka të bëjë me këtë parcelë. Informatë tjetër për juve, kjo kompani, e cila me vite tëra bashkë me neve e ka përgatitur PZhK-në, nuk do ta lejonin që të njejtat parcela t’i parashohim për pendë dhe të njejtat parcela për panela solare. Nuk shkon kjo, nuk shkojnë këto dyja. Bashkë me Ilirin edhe unë jam i kësaj komune dhe gjithashtu është në interesin tim t’i ruajmë këto parcela. Si obligim moral, e kam lutur Ilirin në telefon në lidhje me ftesën dhe nëse unë nuk reagoj, reagojnë tjerët dhe brenda 4-5 viteve edhe qytetarët do të mendojnë që unë e kam përgatitur një material për ta shitur rrjedhën e ujit. Nuk është

rrjedha e ujit këtu dhe nuk ka lidhje sepse parcelat janë të komunës. Parcela (8748-1) që menaxhohet prej Agjencionit të Ujërave, e që ky burim i ujit kalon i ka gjithsej 9 ha dhe është pronë shtetërore e Kosovës. Sipërfaqja që me PZhK është e paraparë për digën e ujit, nuk është pronë e komunës, por të Agjencionit Pyjor dhe prona private. Është ideuar të fillojë të ura që shkon për rrugën Rahovec-Drenoc dhe të përfundojë në sipërfaqet që janë me numra të precizuara saktësisht me grafikone në PZhK, se cilat pjesa do të preken me ujë në rast se ndërtohet diga. Kur e kam lexuar ftesën e asambleistit, bashkë me gjeoderë, sot kam dalur në terren, që ta siguroj veten para se të dal këtu në mikrofon. E kam kufizuar hapësirën ku është e paraparë për digë dhe cila pjesë mendohet që preket me ujë. E kam incizuar lartësinë mbidetare të urës që shkon për Drenoc, rrethrotullimin Rahovec - Drenoc dhe këto parcela që ju prezantova. A e dini ku është pjesa ku po ideohet të bëhet diga? Fillon te ura Rahovec - Drenoc. A e dini ku është kjo parcelë? Bazeni “Behari” dhe kjo parcelë është më lart se ky bazen, kurse nëse shkojmë te kjo parcelë kush e ka vizituar shtegun e ecjes, burimi i atij uji që ka folur asambleisti, buron në fund të këtij shtegu që kufizohet me zonën e Zatriqit. Këto dy parcela janë të komunës dhe nuk kanë lidhje me ujëra, nuk ka burim në këto dy parcela. Afër atij burimi ka prona private që pronarët kultivojnë bujqësinë dhe i ujitin produktete tyre. Në fund, lartësia mbidetare ku janë këto dy parcela 541m dhe larg qoftë ose inshallah sa më shpejt bëhet diga, e në qoftëse e merr uji këtë parcelë, uji do ta merrë edhe urën që na qon për Drenoc, sepse kjo parcelë është më lart sesa rrethrotullimi që na qon për Drenoc. Uji do ta merr edhe rrethrotullimin për Drenoc, e larg qoftë edhe neve. Diga inshallah bëhet dhe vendimi të merret, por uji inshallah nuk na vjen deri te reka.

Albnor Mullabazi: Faleminderit kryesues! Në moment kur e kemi prezantuar PZhK-në, e kemi cekë që Plani Zhvillimor e mbulon tërë territorin e Komunës së Rahovecit. Nuk e di a e keni vërejtur në faqe 368, qëllimi 11.3 është i cekur pellgu ujëmbledhës - Zhdredhë. Parcelat e destinuara për pellgun vazhdojnë prej rrugës së vjetër për Drenoc me sipërfaqe mbi 12/13 ha. Parcelat që sot po diskutojmë, gjithashtu kanë qenë si kërkesë dhe kanë ardhur në PZhK. Këto parcela, me vijë ajrore janë 650m larg parcelës ku është planifikuar të bëhet pellgu ujëmbledhës. Edhe nëse ne e votojmë kundër, ajo zonë është e destinuar për energji solare në PZhK 2023-2031. Implementimi i panelave solare do të montohen 2m mbi tokë, kjo i bie që asnjë burim i ujit nuk do të preket. Gjithashtu panelat nuk mund të vendosen afër burimit të ujit, ne e dimë që për ta vendosur një panelë solare duhet të kemi rreze të diellit dhe askush nuk i vendosë panelat në luginë. Ilirin e përkrahi në këtë iniciativë dhe shpresojmë që do të përfitojmë ndonjë grant apo donatorë, sepse komuna nuk ka kapacitete për ta bërë e vetme. Sipërfaqen e kemi, e presim qeverinë ose ndonjë donatorë për përkrahje.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Një pyetje e kam për drejtorin si sqarim. Këtu ku është lëshuar vërtetimi urbanistik, vendi dhe shuma duhet të përmirësohen dhe numri ëdhtë 2266-0, ndërsa ne këtu po flasim për parcelën 02302-0 dhe tjetra 02290, dmth bëhet fjalë për parcela të ndryshme.

Kryetari: Fillimisht i përgëzoj dy drejtorët e dy drejtorive, Afrimin dhe Albnorin. Po ashtu e përgëzoj kuvendin e komunës për votimin njëzëri të Planit Zhvillimor Komunal dhe e vlerësoj entuziazmin e madh të anëtarëve të kuvendit, në veçanti për ata që kanë besuar për një temë të rëndësishme siç është stadiumi, si dhe me kënaqësi e përgëzoj edhe Ilirin (jo për replikë) që ka arritur ta vë në lajthitë, përmes një thirrje publike (që mendoj që nuk është serioze), sepse kur të bëhet një thirrje publike për mosvotim, duhet të ndodh diçka e madhe me shumë argumente. Ne po harrojmë që e kemi votuar PZhK-në, gjithashtu e kemi votuar zgjerimin e zonave ndërtimore, për biznese, për energji diellore etj etj... Besoj që ky e ka për bindje personale dhenuk po e vë në dyshim që e ka qëllimin e mirë, mirëpo të gjitha informacionet që mund t'i prezantojë nuk kanë asgjë të përbashkët me realitetin. Ne vazhdimisht e kemi kërkuar një pellg ujor, sepse e kemi menduar ta shfrytëzojmë për shkak të burimeve që i ka në atë pjesë. Me PZhK, ju e dini që nuk mund t'i cënojmë pronat që janë në menaxhim, psh: ujërat menaxhohen nga Departamenti i Ujërave. Pavarësisht qëllimit të mirë, bravo i qoftë Ilirit që ka arritur ta vë në dilemë kuvendin e komunës. Nuk e di nëse e ka qëllimin ta jap mesazhin që dikush është për digën, e dikush jo! Unë dje të gjithë jemi pro digës. Në PZhK janë të parapara lokacionet ku do të ketë energji diellore. Mos harroni, komuna jonë ia ka dhënë

pronën e saj në shfrytëzim Ministrisë së Ekonomisë, për qëllime të mëdha dhe të gjithë kemi konkluduar të PZhK-ja e re hap shtigje të reja. Energjia diellore është energji e ripërtitshme që nuk shkakton ndotje dhe që panelet kanë një afat dhe gjithashtu nuk është mirë që dikush të bën thirrje, t'i thotë investitorëve që mos të investojnë në energji diellore. Kjo konsiderohet thirrje e papërgjegjshme. Meqenëse është me Plan Zhvillimor, unë e ftoj Ilirin që mos të tërhiqet dhe të punojmë për digën. Po e përsëris edhe njëherë, Ilir Pallqa, unë e kuptoj shqetësimin tënd, por shqetësimi yt nuk është i bazuar në informacionin konkret që disponon kadastra dhe që është në përputhshmëri të plotë me PZhK-në e re. Tentoj që t'ia tërheqi vëmendjen qytetarëve të komunës që mos i besoni thirrjeve të papërgjegjshme, të pabazuara, tendencioze dhe janë në emër të një investimi që nuk e ke “kaqikin” as ti dhe fatkeqësisht as unë që ta bëjmë digën sot, por edhe nëse e bëjmë sot, diga e ka vendin.

Hasan Përboqi: Faleminderit kryesues! Së pari, faleminderit drejtor i Gjeodezisë dhe Urbanizmit për sqarimet e bëra. Nëse e ka pasur dikush të paqartë, nëse ka dashur, ka arritur ta kuptojë. E kam një pyetje dhe nëse ka përgjigje konkrete, do ta largojë çdo mjegullirë që ka mundur t'i krijohet asambeistit. Cila shtrihet në lartësi më të madhe mbidetare, ujëmbledhësi, diga, apo parcela në fjalë? Nëse parcela në fjalë shtrihet në lartësi më të madhe sesa diga, apo ujëmbledhësi, logjikisht asnjëherë nuk do të paraqiste problem që uji të arrijë deri te parcela, fjala është nëse diga është në lartësi më të ulët.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Të them të drejtën, forma e komunikimit nuk po më pëlqen, as prej kryetari, as prej drejtorit. Iliri ka pasur një ide të veten, ka bërë thirrje për mosvotim. Nëse kërkojmë ta bindim, duhet jo të sillemi ndryshe, por normal dhe duke i kërkuar mirëkuptim me argument. T'i themi po bën dezinformatë dhe njëkohësisht voto, dyjat bashkë nuk shkojnë sepse është nxitëse. E dyta, drejtor, parcela (së pari numri më duket është gabim, 2302-1 dhe jo - 0) sepse -0 nuk ka në gjeoportal. Parcela fillon rreth 1km larg prej urës aktuale. A ka rregullore sa duhet të jetë larg shtratit të lumit vendosja e paneleve, sepse është një zonë e mbrojtur? Mos është më e udhës ta votojmë këtë parcelë me koordinata në pjesën e ujit që ta dimë deri ku i ofrohet rrjedhjes së lumi? Është fakt që lartësia mbidetare është shumë më e madhe dhe uji duhet të del mbi rrugë, nëse e merr atë pjesë. Por, megjithatë ata të paneleve solare mund ta bëjnë ndonjë studim dhe të thonë që ne i kemi bërë panelat solare, po sipas studimit gjatë të reshurave rritet niveli i ujit dhe rrezikohet paneli. Unë nuk jam kundër investimit, por ta kufizojmë, me panel solar fillon në këto koordinata dhe së paku te pjesa e poshtme në raport me rrjedhën e lumit (Rimnikut).

Defrim Kafexhiu: Faleminderit kryesues! Të nderuar drejtorë, kolegë, media, zyrtarë komunalë. Duke e dëgjuar drejtorin dhe ndoshta ndonjëherë kam dyshuar në aftësinë e drejtorëve, por, shumë po më bind në aftësitë e mira komunikuese drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër, një vlerësim i mirë për këtë. Nëse nuk do t'ju njihna, këtë pikë të rendit të ditës do ta votoja me dy duar, pas atij fjalimi të drejtorit Afrim Oruqi. Sa e kuptova unë, ju ekzekutivi burra të mirë, ne burra jo të mirë. E keni marrë gabim këtë çështje, ne nuk jemi kundër investimit, nuk jemi as kundër investimit të paneleve solare. Jemi pro investimit, por mua po më duket çështje pak e ngutshme, sepse së pari duhet të shikohet rrjedha të ideja e anëtarit ynë i kuvendit. Kurrëfarë problemi nuk kemi që pronat të jepen me qera. Ka prona që edhe me PZhK janë ndarë për çështjen e paleneve solare dhe unë besoj që është e mundur që kjo parcelë të jepet edhe diku tjetër. Në atë pjesë, Iliri në postim e ka cekur rrjedha e lumit, jo burimi i ujit. Rrjedha e lumit kalon nëpër parcelën që ju po dëshironi ta jepni për 25 vite me qera. Çështja e ujëmbledhësit që e përmendi drejtori i Urbanizmit është me kufi me parcelën që ju doni ta jepni me qera për 25 vite. Drejtor, e keni edhe hartën përpara dhe e sheh që rrjedha e ujit kalon nëpër parcelën në fjalë. Ju mund ta jepni një pjesë të parcelës më lart, 5ha më lart ose më posht. Askush nuk është kundër investimit, as Iliri e as ne si grup. Dyshoj që kjo ka qenë e qëllimshme dhe ju keni vendosur që për këtë çështje ta jepni parcelën në shfrytëzim. E kam këtë dilemë, përndryshe ka mundur të jepet edhe ndonjë sipërfaqe tjetër dhe besoj që duhet të jepet. Kjo çasje e juaja nuk është e mirë, të thoni që na e kemi mirë dhe ju jeni kundër investimeve të paneleve solare dhe që abstulutisht nuk është e vërtetë. Unë besoj që edhe ju nuk jeni kundër digës, kështuqë jemi bashkë për investime. I realizojmë investimet në një formë që duhet të jetë e kënaqshme.

Kryetari: Nëse flasim për digën, në PZhK-në e vjetër 2013, që ka qenë një asamble me anëtarë tjerë dhe ekektiv fatbardhësisht (apo fatkeqësisht për disa, merreni si të doni) kam qenë unë dhe është paraparë që atëkohë. Pra, ne që nga ajo kohë kemi instistuar ta kemi një digë, sepse janë bërë hulumtime, fatkeqësisht edhe nga Serbia, por edhe nga shtetet që sot jemi partnerë. Askush nuk pretendon të thotë që ne jemi për panele solare dhe dikush është kundër digës dhe anasjelltas. Ne duhet të jemi korrekt në informacion dhe mos të ngarërrohemi duhet u treguar jobashkëpunues dhe refuzues me biznese. Kjo nuk është çështje e ngutshme, sepse PZhK është në diskutim që prej mandatit të Idriz Vehapit dhe ka ngelur me vonesa dhe unë jam në mandatin e dytë rresht dhe mezi e kemi finalizuar me ligjshmëri. Dua ta citoj një moment me Ilir Pallqën, i cili menjëherë të nesërmen ka ardhur dhe ka pyetur se a kemi mundësi ta marrim terrenin për stadium. Kjo pikë e rendit të ditës është dashur të jetë në dhjetor ose janar dhe kërkesat që janë bërë për parcela për panele solare janë konkretisht të specifikuara. Prona që është në Guri të Kuq është kërkuar nga qeveria e Kosovës për shfrytëzim dhe e vetmja herë që jam falenderuar nga kryeministri, duke ma përmendur emrin në mbledhje të qeverisë për fleksibilitetin e treguar si kryetar komune. Në ankand kanë aplikuar 6 kompani dhe nëse më pyetni se kush do të dëshiroje ta fitonte, kisha pasur qejf që të jetë “Orllati” sepse është kompani e fortë nga komuna jonë. Ju lus që mesazhin që e kemi dhënë për PZhK-në bashkërisht dhe njëzëri, duhet të votojmë njëjtë për ksi lloj investimesh, sepse bëhet fjalë për zhvillim të komunës. T’ia zgjasim dorën njëri-tjetrit për investime, nuk ka lidhje a është diga apo palenet solare, bashkërisht ta japim mesazhin që komuna e Rahovecit është e hapur për investitorë.

Ilir Pallqa: Më falni, uroj që nuk po ju bezdisi. Po mundohem të jem i qartë, se di sa mundem. Projekti i PZhK-së me gjasë ka pasur kosto 30.000€. Veç analiza e mirëfilltë për këtë çështje që kam biseduar me njerëzit kompetentë, e din edhe kryetari për akumulim të ujit, ka kosto 200.000-400.000€. Thirrje kam bërë që paraprakisht të bëhet një analizë e mirëfillt. “Këtu kalon rrjedha kryesore e ujit vazhdimisht gjatë rrjedhës së dimrit, e nëse nga matjet që mund të bëhen rezulton që është tokë e përshtatshme për akumulim të ujit, atëherë ideja për liqen apo pendë akumuluese, kufizohet”. Nga matjet që mund të bëhen nesër, nëse vendosë ekzekutivi që ta bëj një ekspertizë, ajo kufizohet. Drejtori tha që krejt kjo pjesë do të jepet. Unë jam atje çdo ditë. Rrjedha e ujit është në kufi me parcelën dhe nëse ekspertët e përcaktojnë që veç 2m të bëhet diga këtu, e përfshin pjesën ku ne po e japim sot. Drejtori tha që pishina “Behari” është më poshtë, apo jo? Nuk e di a po shihet qartë, nëse ekspertët e përcaktojnë që aty është vendi më i përshtatshëm që të bëhet diga 20m, e gjithë parcela përfshihet me ujë dhe nuk del te rrethi që the ti aty. Unë them që akumulimi i ujit mund të bëhet vetëm aty ku ka ujë, kurse energjitë solare mund të bëhen edhe atje ku nuk ka ujë. Qindra hektarë tokë i ka komuna për t’i dhënë. Me këtë gjë, më duket që po e cënojmë një potencial zhvillim të Rahovecit. PZhK-në ne e kemi votuar, por edhe mund ta tjetërsojmë duke e ndryshuar pak. Sinqerisht, unë si Ilir, nuk e kam folur më herët këtë çështje, sepse kam pritur të përfundojë çështja e stadiumit. Urojmë që pika të shtyhet dhe ta kërkojmë ndonjë vend tjetër për këtë pjesë.

Burim Krasniqi: U mundova të flas ulur, por më duket që pa dalur në foltore nuk po merret parasysh fjala! Kështu, nuk duhet ta bëj rolin e avokatit për askënd, por dokumentin më të madh PZhK-në e kemi votuar dhe e bëfshim “me shnet”. Pasi që nuk e kemi shikuar atëherë, duhet ta përbijmë. Në çoftëse ajo parcelë parashihe të jepet për panel solar, LDK në asnjë moment nuk do të del kundër investimeve nga investitorët e jashtëm, derisa nuk cenohet ndonjë pjesë shumë e rëndësishme e Komunës së Rahovecit. Kryetar, e bëra një pyetje, pasi dola, po e përsëris përsëri, duke pasur parasysh që parcela shkon deri te vija e rrjedhës së lumit dhe rrjedha e lumit nuk ka pronë të veten shumë të madhe. Ndoshta do të ishte më e udhës t’i japim koordinatat deri ku guxojmë t’i ofrohemi rrjedhës me këtë vendim. E dyta, ligji për ujëra e konfigurron deri sa guxojmë t’i ofrohemi ujit dhe nuk guxojmë se si na teket ta bëjmë këtë punë. E fundit, në bazë të PZhK-së dhe në bazë të asaj që është diskutuar, nëse bëhet ndonjëherë diga, parashihet të bëhet te rruga për Drenoc dhe jo te parcela lart.

Sinan Kryeziu: Faleminderit kryesues! Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës mendoj dhe vlerësoj që duke e njoftur Ilirin, që kemi qenë edhe kolegë në parti. Besoj që Iliri nuk është duke bërë politikë, por thjesht beson në atë

që konsideron që është e drejtë. Gjithashtu mendoj që nuk e ka të drejtën e botës t'i bëjë këto propozime këtu në kuvend. Ilir duhet ta ketë parasysh që në kuvend edhe ne i kemi të drejtat tona kur një pikë vendoset në votim, të votojmë pro apo kundër. Mendoj që këtu ballafaqohemi me ide dhe argumente, aq sa i dimë dhe as sa na kanë servuar ekspertat e fushës. Mendoj që duhet ta vendosim në votim dhe nëse ka Iliri të drejtë, atëherë pika nuk kalon. Në anën tjetër, nëse ne kemi të drejtë, kalon.

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! Në pyetjen e kuvendarit z. Rasim Fazliu të cilin e falënderoj për këtë korrigjim. Për shkak të volumit të madh të punës edhe mund të ndodhin gabime të tilla teknike. Bashkë me Skenderin dhe me zyrën ligjore me Mirsadin, sa herë që keni dhënë vërejtje konstruktive, i kemi korrigjuar.

Në pyetjen e kuvendarit Hasan në lidhje me lartësinë mbidetare, ne sot me gjeodetë i kemi matur këto lartësi që të sigurohemi para se të flasim dhe lartësia e parcelës është më e lartë sesa lartësia e urës që na qon për Drenoc dhe më e lartë sesa rrethrotullimi që na qon në drejtim të Malishevës. Në pyetjen e kuvendarit Burim Krasniqi, këtë dokument e kemi përgatitur disa muaj më herët, sepse ka pasur disa kërkesa në drejtori përkatëse dhe kanë shprehur interesim për t'i marrun në shfrytëzim dhe nuk kemi mundur t'i vendosim në kuvend për shkak të PZhK-së. Ne e kemi konsultuar Ministrinë e Ekonomisë dhe ky çmim nuk është i rastësishëm dhe është i barabartë me çmimin që e ka ofruar Ministria e Ekonomisë për parcelat në Kramovik dhe në Guri të Kuq. Pasi që të vjen ligjshmëria, përgatitja e dokumentacionit zgjatë minimum 30 muaj, ideja është që janë 2539€ në muaj që do të obligohet t'ia paguaj komunës cildo që e fiton. Kjo parcelë menaxhohet prej Agjencionit të Ujërave dhe ata do ta shohin se sa i ofrohet ujit dhe nëse nuk përshtatet do të na kthejnë të kundërligjshme. Ne jemi të gatshëm për përmirësim dhe sa do që të ketë nevojë t'i ikim rrjedhës së ujit. e që është pronë e Agjencionit të Ujërave, ne do ta përgatisim një skicë tjetër me koordinata tjera, duke e zvogëluar numrin e sipërfaqes në vendim. Ju ftoj që pas shqyrtimit ta votoni këtë pikë të rendit të ditës.

Leonard Morina: Faleminderit kryesues! E falënderoj Iliri, drejtorin, Burimin dhe të gjithë ata që kontribuan në këtë pikë. Mendoj që në kuvend nuk ka dezinformues, por ka njerëz që mundohen ta japin kontributin në atë që e dinë. Meqenëse ka shumë paqartësi, kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për në seancën e radhës dhe në seancën e radhës duke i analizuar më shumë detajet, dalim me një përfundim dhe ata që dëshirojnë ta votojnë, e votojnë.

Merisa Sharku: Pajtohem me Leonardin. Unë dola këtu që ta shprehi mendimin tim dhe ta vërtetoj nga ju a e kam kuptuar si duhet këtë çështje. Me thënë të drejtën nuk kam shkuar asnjëherë në vizitë në këtë parcelë. Historikisht në atë vend ku krijohet lugu, ka pasur dikur rrjedhje të ujit dhe është mundësia të ketë prapë. Në PZhK thuhet që kjo parcelë është e destinuar për solar, këtu po vrehet që komplet parcela jepet me qera për një kohë shumë të gjatë (25 vjet). Poshtë shihet që ka rrjedhje të ujit dhe kufiri i parcelës që jepet është me kufirin e ujëmbledhësit në PZhK. Këtu është ujëmbledhësi dhe prej kësaj pike këtu, po jepet me qera. Gjithsesi, nëse dikujt ia japim pronën për 25 vjet është problem që tutje t'i ndërhyjmë në pronë, historikisht e dimë. Këtu po shihet shumë mirë që ka rrjedhë të ujit, gjithashtu edhe në PZhK. Mendimi im është që mund t'ia japim gjysmën prej së larti parcelën në fjalë investitorit.

Kryetari: Faleminderit kryesues! Informimi i drejtë është iformatë reale dhe e bazuar në faktografi. Drejtorët e drejtorive i dhanë shpjegimet, pati edhe kërkesa për sqarimi si ajo e Rasimit dhe Burimit. Ajo që bie ndesh me këtë është dezinformata dhe asnjëherë nuk thash që është e qëllimshme. Politika e ka një parim dhe një standard, në çoftëse ne rrahim gjoks këtu dhe themi që të gjithë jemi për investime dhe në anën tjetër kërkojmë që pika të shtyhet, nuk shoh që ka sinqeritet. E përgëzova Iliri, sepse ka besuar në atë. Sqarimet u dhanë dhe e ftoj kryesuesin që ta vendosë në votim dhe besoj që ka arsye të fortë që të votohet “për” nga të gjithë.

Kryesuesi: Faleminderit kryetar, atëherë, e kalojmë në votim këtë pike. Kush është “për”?... Unanimisht me vota të anëtarëve të kuvendit kalon kjo pikë e rendit të ditës.

7. Raporti nga Zyra e Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 dhe diskutimi i planit të veprimit;

Ruzhdi Kabashi: Faleminderit kryesues! Para jush po paraqes raportin e punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për periudhën janar-dhjetor 2023. Kjo periudhë ka qenë e bazuar kryesisht në planin vjetor të punës, i cili është i aprovuar nga kryetari i komunës. Bazën ligjore e ka ligji Nr. 06L/021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, udhëzimet administrative për auditim të brendshëm, doracakun e auditimit të brendshëm, statutin e auditimit të brendshëm dhe instruksionet lidhur me standartet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm. Sipas planit vjetor të njesisë së auditimit të brendshëm për periudhën janar-dhjetor 2023, kemi arritur t'i kryejmë 6 auditime. Në këto auditime kemi dhënë gjithsej 21 rekomandime, nga 21 rekomandime deri në fund të vitit 2023 janë implementuar 11 dhe 10 prej tyre janë në proces dhe vazhdojnë deri në 6-mujorin e parë të vitit 2024. Me datë 23.02.2024 një vlerësim nga USAID-i amerikan për rezultatet e gradimit për Komunën e Rahovecit për vitin 2023. Gjatë vitit 2023 janë implementuar edhe 4 rekomandime që janë dhënë gjatë vitit 2022, që kanë pasur afatin për implementim gjatë vitit 2023 dhe do të thotë që gjatë vitit 2023 janë implementuar 15 rekomandime (78.9%). Në bazë të vlerësimit nga USAID-i njësia e auditimit është vlerësuar me notën 3.5 pikë nga gjithsej 4 pikë sa ka qenë maksimalja.

Kryesuesi: Faleminderit Ruzhdi! Seanca ndërpritet sepse për moment mungon kuorimu. Një pauzë pesë minuta.

Feriz Thaqi: Kryesues, kërkoj që seanca të vazhdohet nesër. E këta që po dalin, le të vinë nesër.

Leonard Morina: Faleminderit kryesues! Raportin e kam lexuar dhe e pashë që janë përfshirë 6 drejtori nga të cilat janë nxjerrë 21 rekomandime. Po të ishin të përfshiera të gjitha drejtorit, ku ta di se sa rekomandime do të dilnin. Gjatë leximit të këtij raporti, vërejtja atë që e kam përsëritur vazhdimisht në disa seanca, dallimin në mes planifikimit dhe realizimit. Në këtë raport edhe auditori e ka cekur që ka një analizë të dobët në mes të planifikimit dhe realizimit. Auditimi te Drejtoria e Shërbimeve Publike i ka tri çështje dhe në përgjithësi del që kjo drejtori ka pasur neglizhencë në lidhjen e kontratave për pronat komunale, si dhe si pasojë e kësaj është dëmtuar buxheti komunal. Pyetje për drejtorin: Pse ka pasur neglizhencë në lidhje të kontratave, ku qëndron problemi? Auditori i Brendshëm me shumë vërejtje edhe për Drejtorinë e Shëndetësisë. Nga 19 objektivat të cilat i kishte auditori, vetëm 4 prej tyre Drejtoria e Shëndetësisë dhe stafi i saj kanë referuar mostra dhe materialin e nevojshëm, ndërsa për 15 objektivat të tjera nuk e ka ofruar materialin e nevojshëm. Pyetje: Mbi çfarë baze ligjore refuzoni bashkëpunimin me auditorin për të cilin ligji i obligon të bashkëpunoni dhe t'i publikoni pagesat, kontratat etj... Konkluzioni i auditorit thotë që nuk janë prezantuar disa materiale, nuk kanë paraqitur dëshmi për shpenzimet e kujdesarive, nuk kanë paraqitur dëshmi për pranimin e mallrave dhe shërbimeve, nuk i kanë paraqitur të dhënat se sa ka pasur të hyra, nuk kanë ofruar dëshmi për menaxhimin e kontratave, nuk kanë ofruar dëshmi për shpenzimin e derivateve dhe krejt në fund dhe më shqetësuesja, nuk kanë ofruar dëshmi se si janë shpërndarë barnat. Pse i keni fshehur këto të dhëna, a ka dyshim për keqpërdorim apo keqmenaxhim?... Kjo drejtori përkundër stafit administrativ të madh e disa zyrtarë ligjorë, nuk po tregohet efikase. Ndoshta problemi qëndron që QKMF-ja nuk ka drejtor dhe vazhdon që disa vite vetëm me ushtrues detyre. Kryetar, pse nuk e zgjedhni drejtorin në mënyrë që ta rrisni efikasitetin e punës dhe të orientoni përgjegjësinë. Cila është përgjegjësia ligjore e drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe kryetarit për këtë neglizhim dhe mosbashkëpunim me auditorin? Te Drejtoria e Financave, te çështja 4: Sipas ligjit për menaxhimin e financave publike çdo fakturë e vlefshme, e cila është për pagesë, qoftë mall apo shërbim, duhet të paguhet brenda 30 ditëve, përndryshe operatori ka të drejtë t'i drejtohet përmbaruesit dhe komuna përveç që duhet t'i paguaj faturat, duhet t'i paguaj edhe obligimet e përmbaruesit. Sipas listës së obligimeve, komuna nuk ka arritur t'i paguaj 135 fatura që e kanë kaluar afatin ligjor dhe që vlera e tyre është 1.636.000€. Nëse kësaj shume i shtohen edhe shpenzimet pëmbarimore, "vaj halli për komunën". Disa herë kryetari është thirrur në atë që operatorët po na mirëkuptojnë dhe nuk po na dërgojnë në përmbarim. Realisht ata ndoshta nuk i dërgojnë, por nëse nesër prishen me kryetarin (hidhërohen), e që nuk e marrin ndonjë tender, ata do t'i drejtohen përmbaruesit. Këtu nuk humb kryetari, por

komuna. Sido që të jetë, komuna është “borgjli” ndaj operatorëve edhe kur ata e mirëkuptojnë kryetarin, por edhe komuna ndoshta i mirëkupton operatorët qoftë edhe me ndonjë tender.

Kryetari: Ne, për performancë (sepse është indikator) e publikojmë Raportin e Auditimit të Brendshëm, përndryshe ligji e ndalon decidivisht dërgimin e raportit të auditimit në kuvend të komunës. Kurse raporti i ZKA-së është obligativ të diskutohet në kuvend. Rekomandimet që i ka auditori i brendshëm me ligj janë të rregulluara që i merr auditori i jashtëm, në këtë rast ZKA-ja. Para 3 dite e kemi pasur një takim me USAID-in dhe kemi dalur e vlerësuar si komuna me 76,94 pikë, e para në Kosovën. Me fjalë të tjera, auditori i brendshëm është në funksion të komunës dhe e ndihmon kryetarin dhe ekzekutivin për ta respektuar ligjshmërinë në çfarëdo veprimi. E falënderoj Ruzhadinë për prezantim.

Burim Krasniqi: Së pari, falënderoj auditorin e brendshëm për raportin. Raporti është me të paraqitura të kënaqshme. E dyta, sa i përket asaj që në performancë jeni komuna më e mirë, të gjithë ktu ju kemi lëvdur edhe Iliri që ndonjëherë është më i ashpër. Këtu ose ka gabim procedural ose diçka nuk është në rregull, nëse e ndalon ligji, pse atëherë e kërkon raporti i performancës informimin në kuvend të auditorit të brendshëm? Nuk mund të jetë në kundërtënie njëra me tjetrën, sepse kriteret e performancës i bën MAPL-ja. Unë dua ta marr minutazhën e grupit të asambleistëve të LDK-së, për të diskutuar për secilën çështje që kemi vlerësuar që ka nevojë për t’u diskutuar. Nuk mendoj që ka diçka që është sekret për të zgjedhurit e qytetarëve. Transparenca nënkupton që përfaqësuesi i qytetarëve të ketë çasje. Në fund të fundit, për këtë që e ka shkruar auditori i brendshëm, ne mund të bëjmë kërkesë me shkrim për çasje në dokumente zyrtare dhe mund ta shohim. Sa i përket raportit, te Drejtoria e Shërbimeve Publike: Pse ka nevojë 9 objekte prej 18 të jenë pa kontrata? Kjo është neglizhencë. Te çështja 3 te Drejtoria për Ekonomi, te konkluzionet: Edhe pse ka pasur evidencë për regjistrimine të hyrave nga taksat komunale, mosinkasimi i arkëtueshëm nga çdo obligues ka rezultuar që të krijohen borxhe të këqija dhe paraqet gjendjen e llogarive të arkëtueshme për borgje. Kjo nënkupton që moslypia e borxheve, ose mosndjekja e procedurave për inkasimin e borxheve vijnë në një situatë kur themi “hajde t’i falim disa borxhe të këqija, sepse akumulojmë borxhe të këqija”. Është diçka që vetë komuna po e shtyen që të ndodh dhe të bëhet borxh i keq dhe të vie një situatë ku komuna i falë këtë borxhe. Kryetar, te Drejtoria e Shëndetësisë unë kam pritur që kur foli Leonardi, reagimi yt do të ishte duke thënë që “unë i kam marrur veprimet konkrete të zyrtarëve përgjegjës për mosbashkëpunim me Auditorin e Brendshëm” dhe ta arsyetosh mosbashkëpunimin. Auditori i Brendshëm është mekanizmi kryesor që të ndihmon ty personalisht në menaxhimin e Komunës së Rahovecit. Kur menaxhmenti dhe zyrtarët e Drejtorisë së Shëndetësisë nuk i kanë ofruar bashkëpunim auditorit të brendshëm, kjo nënkupton që ata po fshehin diçka edhe prej teje. Ditëve në vijim pres që të keni masa konkrete rreth zyrtarëve përgjegjës për mosbashkëpunim me Auditorin e Brendshëm dhe jo arsyetim të tyre për mosbashkëpunim. Për mua Drejtoria për Shëndetësi është shqetësuese, aty (pa dashur të shprehem) dhe secili prej neve mund të paragjykojë që aty mund të ketë diçka të madhe që fshehet. Nuk dua të besoj, por fakti që mungon informata, nënkupton që diçka fshehet. Te Administrata ka disa rekomandime, që auditore e ka cakur që ka pasur konkurse, ku në konkurse është kërkuar profesion tjetër dhe janë pranuar zyrtarë përgjegjës me profesion tjetër. E kemi cekur edhe këtu, ka qenë rasti i Inspektoratit dhe kur i kemi thënë drejtoreshës se si keni kërkuar inxhinier të ndërtimtarisë dhe keni pranuar me drejtime të tjera, ka thënë që këtë punë nuk e bëj unë, por e bën personeli që menaxhohet prej Drejtorisë së Administratës. Te çështja e ndërtimit të parqeve në komunë, çështja 3: Këtu janë disa vërejtje te një kontratë që besoj që është një vjeçare dhe për këtë arsye ka ndodh që planifikimi buxhetor të dallohet në vitin 2021 prej kostos së kontratës, sepse ka qenë 3 vjeçare. Te çështja 4: Te projekti i marrëvedhjes së nënshkruar te parqet në mes MAPL-së, Komunës së Rahovecit dhe Demos-it, 2022 thotë në të gjitha projektet ka pasur vonesa në implementim. Kontrata thotë që në qoftëse projekti nuk realizohet brenda afatit kohor siç është përcaktuar në marrëveshje, bashkëinvestitori tërhiqet. Auditori ka qenë modest në konkluzion, duke thënë që është shkaktuar mosmirëmbajtje të parqeve për shkak të tërheqjes, por realisht në qoftëse Demos-i është tërhequr, aty kemi edhe dëmtim të buxhetit të Komunës së Rahovecit, sepse pjesën tjetër të donacionit besoj që është dashur ta mbulojë

Komuna e Rahovecit. Për shkak të neglizhencës dhe vonesës komuna ka paguar para shtesë sa i përket investimeve në parqe në bashkëinvestim me Demos-in. Te çështja 5 thuhet që është shkaktuar mungesa e mirëmbajtjes dhe shqetësimi i ngritur nga auditori thuhet që ka pasur dëmtim të dunjve dekorativë nëpër parqe, këtë shqetësim dikur e ka ngritur Faton Ramadani. Te Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Leonardi e ceku dhe me të vërtetë e kam thënë edhe në momentin kur është diskutuar raporti financiar. Gjithmonë planifikimi është më i ulët që të del performanca më e lartë në inkasimin e të hyrave. Këtu nuk është një përputhje e mirëfillt të hyrave dhe planifikimit për të hyra. Te çështja 3, te barazimi thotë: Drejtoria nuk ka arritur ta bëjë harmonizimin e të dhënave dhe te konkluzioni thotë që, mosrealizimi i barazimeve mujore në mes drejtorisë komunale me zyrtarin e të hyrave rrezikon në kontrolle të brendshme. Kryetar, a ju ka shqetësuar kjo çështje ndonjëherë dhe a keni diskutuar me drejtorin se pse po ndodh kjo dhe a ka krijuar një huti më të madhe duke marrur parasysh borxhet që i ka Komuna e Rahovecit? Te Drejtoria e Financave është çështja e fundit që e kam, çështja 4: Vonesat në pagesat e faturave janë 135 raste (që nuk janë paguar brenda 30 dite). Por është edhe diçka shumë interesant, në raportin vjetor financiar keni thënë që borxhet janë 900.000€. Në çështjen 4 të auditorit thotë që janë 1.606.000€. A janë 900.000€, apo 1.6 milion€ borxhe që i ka pasur Komuna e Rahovecit në fund të 2023? Këtu është një mospërputhje. Nuk dua ta zgjas më tepër, auditor faleminderit. Kryetar, ndoshta e merr ndonjë poen te performanca, sepse të jetë raporti në kuvend dhe të thuash që nuk e kam obligim ligjor ta diskutoj, atëherë as ne nuk jemi të bësh “hajgare” me ne.

Kryetari: Unë për t’i fituar 1.644.000€ jam në gjendje ta pranoj edhe akuzën edhe pse nuk ka kurrëfar baze. Auditori i Brendshëm i raporton vetëm kryetarit të komunës dhe jo kuvendit, është e sanksionuar me ligj. I shihni komunat tjera në performancë kanë zero pikë, sepse nuk raportojnë në kuvend. Ju mund të flisni gjithë ditën, por unë jam i obliguar që vetëm për raportin e ZKA-së, në të cilin janë të gjitha këto që u folën. Rekomandimet që me numër janë 10 këtu, atje bëhen me 1 ose 2. Unë nuk bëj shaka dhe nuk bëj veprime të antiligjshme. Këtë raportit ma kanë kërkuar Zyra e Kuvendit dhe Grupi Punues për Performancë që mund t’i shtojmë dy poena, ose ta lëmë me zero poena. Prandaj e kam bërë vetëm prej vullnetit të mirë, sepse nuk e kemi asnjëlloj obligimi dhe që Njësia e Auditimit të Brendshëm i raporton vetëm kryetarit të komunës. Nuk është gjendja reale ajo që u prezantua në raport, sepse ka shumë veprima pastaj që kanë ndodhur. Auditori vetëm raportin e ka këtu, nuk e ka edhe raportin e zbatimit të rekomandimeve të njësisë së Auditimit të Brendshëm. Burim, nuk di si ta them ndryshe, nuk e kemi pasur obligimi, por sot e kemi paraqitur dhe nga ky diskutim nuk ndërron asgjë, sepse realisht përgjegjësia për këtë çështje i shkon vetëm kryetarit dhe mbetet në diskrecionin e tij për masat, veprimet, ndëshkimet, vlerësimet etj etj dhe që ky raport me automatizëm shkon te ZKA-ja... Kërkoj nga Ruzhdiu ta shpjegoj se si është situata, sepse nuk po e dinë a po diskutojmë rreth raportit të ZKA-së, apo të zyrës së Auditimit të Brendshëm.

Sejfullah Sejfullahu: Faleminderit kryesues! Pasi që kryetari tha është e kot të debatojmë, atëherë nuk po debatojmë. Përkundër kësaj, shumicën e tha Burimi dhe ajo që më bën përshtypje, nëse nuk jam gabim edhe vitin e kaluar ka qenë kështu. Mos mendo që neve po na knaq kjo gjendje që ka shkelje. Te të gjitha rekomandimet, auditori i drejtohet drejtorive, por te Shëndetësia po e vërej që i drejtohet kryetarit të komunës a është puna aq keq?

Kryetari: E para, Njësia e Auditimit të Brendshëm është njësi që i raporton kryetarit të komunës. QKMF-ja ka statut dhe normativë të vetën që e keni miratuar në kuvend të komunës. Normalisht Drejtoria e Shëndetësisë bën vetëm politikat e funksionimit të QKMF-së dhe kryetari i komunës është përgjegjës për implementimin e këtyre politikave. Autoriteti i kryetarit në zbatimin e rekomandimeve është i madh, sepse duhet ta bëj grupin e punës punues, planin e veprimit etj... Tash ne po bëjmë plane të veprimit edhe për Njësinë e Auditimit të Brendshëm.

Burim Krasniqi: Kryetar, çështja e dërgimit në prokurori dhe dënimit, nuk ka qenë asnjëherë praktikë e LDK-së. Merret me punën e veta dhe jo me të kaluarat e qeverive. Nuk e ka vullnetin e dërgimit në përgjegjësi ligjore, janë organet përgjegjëse që paguhet për ta bërë punën e vet. Ne flasim duke tentuar të bëjmë presion pozivitet që të bëhet më mirë. E dyta, Auditori i Brendshëm është syri yt kritik në raport me drejtorinë. Aty ku zyrtarët e brendshëm tentojnë

diçka që të mos raportojnë drejt, auditori thotë që diçka nuk është në rregull. Në qoftëse duhet të jetë një raport për të cilin kuvendi nuk duhet të diskutojë hiç, atëherë është ofenduese ta kemi këtu. Si ndihesh ti, nëse e ke një dokument që nuk ke të drejtë ta hapësh hiç. Ose thua, zonja dhe zotërinj a bën ta vendosim në votim vetëm si informatë prej zyrës së auditorit, pa diskutime dhe vetëm si ndihmë t'i marrim edhe dy pikë në Raport të Performancës dhe që është në të mirë të qytetarëve. Kur t'i dëgjoj këto gjëra e mos të flas, duhet të shkoj në shtëpi për të pirë hapa për lukth. Faleminderit shumë.

Ruzhdi Kabashi: Faleminderit kryesues! Në pjesën e parë i ceka edhe implementimet e rekomandimeve, por shumica e asambleistëve nuk ishin prezent. Te pika e Grantit të Performancës që e ceku asambleisti Burim Krasniqi, donacion i kemi pasur 50.000€. Sa i përket Drejtorës së Shëndetësisë, nuk është në kuptimin klasik të fjalës që nuk kanë qenë bashkëpunues, por ka qenë më shumë edhe koha e pushimeve (korrik). Pasi që e kam përfunduar draft raportin, kam pranuar dokumente prej tyre dhe pastaj nuk e kam pa të arsyeshme t'i fus në raportin final.

8. Raporti mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga ZKA-ja, për vitin 2022;

Afrim Limani: E njëjta temë veç pak më ndryshe, Burim. I nderuar kryesues, kryetar, të nderuar asambleistë. Siç jeni në dijeni auditimi i pasqyrave financiare të Komunës së Rahovecit për vitin 2022 ka rezultuar i pamodifikuar dhe me 9 rekomandime. Në raport me vitin paraprak janë realizuar 10 rekomandime dhe 4 rekomandime janë të përsëritura. Prej 9 rekomandimeve, 5 janë rekomandime të tjera, 4 të përsëritura. Si rezultat i kësaj, ne e kemi formuar një komision për implemendumin dhe zbatimin e këtyre rekomandimeve. Këto 9 rekomandime janë si rezultat i auditimit të vitit 2022. Në këtë takim e kemi nxjerrur edhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, ku me kohë e kemi dërguar në ZKA. Konsiderojmë që nga 9 rekomandime, ne i kemi 5 rekomandime të zbatuara, 4 janë pjesërisht. Gjithësesi jemi duke e pritur raportin final të auditorit 2023 (maj).

Burim Krasniqi: Drejtor, raporti është finalizuar me 27.09.2023, para 5 muajve. Pse është vonuar? E dyta, ky më shumë është plan mbi zbatimin e rekomandimeve se sa raport. Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit, nuk është periudha e zbatimit të rekomandimit (te rubrika e parafundit, te shtylla). Në fund kemi: konsiderojmë që do të zbatohen deri në fund të vitit 2023. Nuk është raport i zbatimit, këtu është dashur të jetë se sa janë të zbatuara rekomandimet, i zbatuar, pjesërisht i zbatuar, apo planifikohet të zbatohet.

Afrim Limani: Burim, data e fundit e dorëzimit të këtij raporti është përafërsisht 23 shtator, që duhet t'i adresohemi ZKA-së. E dyta, ky përngjan me plan të veprimit, por faktikisht është raport, sepse është edhe pjesa tjetër e detajeve ku secila drejtori përgjegjëse i ka edhe raportet e veta. Raportin e kam prezantuar në formë gjenerale dhe kryesorja është që ne pretendojmë që i kemi zbatuar 5 rekomandime dhe 4 pjesërisht.

Burim Krasniqi: Drejtor, materiali që ka ardhur nuk potencon askund a është zbatuar, apo nuk është zbatuar. Është material që më shumë nuk ka të bëjë me raportin e zbatimeve. Kërkoj falje kryesues. Në janarin 2023, kur ka ardhur raporti për zbatimin e rekomandimeve, thuhet: Çështja A1, klasifikimi adekuat i shpenzimeve, i zbatuar. Çështja A2, i zbatuar, A3 i zbatuar ... B2 pjesërisht i zbatuar etj... këto nuk i kemi në materialin tonë.

Afrim Limani: Nëse ka qenë rekomandim 100% i zbatuar, e kemi bërë "i zbatuar". Te çështja A2, konsiderojmë që ky rekomandim pjesërisht do të zbatohet gjatë këtij viti dhe gjatë vitit 2023 ky rekomandim do të zbatohet. Rekomandimi tjetër numër 6, ne e kemi ditur që ka rrjedhë një gabim dhe me një veprim e kemi ditur që është 100% i zbatuar. Pyetjet që ia bërë Ruzhdiut, në raport financiar do të jap përgjigje.

9. Raporti i Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2023;

Lirigzon Kastrati: Faleminderit kryesues! I nderuar ekzekutiv, anëtarë të kuvendit. Materialin për vitin 2023 e keni para jush. Kryesuesja është në udhëtim zyrtar dhe më ka autorizuar që si anëtar i komitetit ta prezantoj raportin. Në pajtim me udhëzimin administrativ 05/2020 për procedurën e themelimit dhe përbërjen e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera, konkretisht me nenin 16, pika 3, jemi të detyruar që kuvendit t'ia dorëzojmë një raport vjetor të

punës. Përbërja e këtij komiteti: Vlora Vuçitërna (kryesuese), Shukrije Himaj, Lirigzon Kastrati (unë), Zana Qmega dhe Armir Vuçitërna. Fillimisht e kemi bërë planin e punës së këtij komiteti dhe kemi diskutuar për vizitat që i kemi bërë gjatë vitit 2023. Të gjitha vizitat janë kryer nga ana e komitetit dhe të gjitha çështjet tjera i kemi diskutuar gjatë mbledhjeve. Besoj që drejtoresha këtë raport do ta merr si formë rekomandimi nga ana e komitetit. Kemi pasur vizita në QMF – Krushë të Madhe, Xërxë, Rahovec – takim me Këshillin e Pacientëve, vizitë në QKMF – Rahovec dhe në Ratkoc. Kërkesat kryesore kanë qenë rreth çështjeve të barnave dhe higjienës.

Hasan Përboqi: Faleminderit kryesues! E falënderoj Lirigzonin për prezantim. Puna e këtij komiteti është për t'u përgëzuar, sepse në disa raste kur kanë reaguar këta si komitet, kanë arritur që ta biejnë punën në atë situatë që të ndërmerren veprimet e nevojshme. Kjo është dëshmi që edhe komitetet tjera në këtë drejtim duhet të punojnë më shumë, duke ngritur ndërgjegjen ndaj punës të çdo institucioni në të mirë të qytetarëve.

Burim Krasniqi: Faleminderit Lirigzon për prezantimin! Te raporti i kam dy sugjerime për raportin e ardhshëm. Raporti ta ketë një përmbledhje të të gjeturave që i hasni gjatë vizitave dhe një përmbledhje të rekomandimeve që i keni dhënë tani dhe për të ardhmen. Në raport është përshkrim i punës së komitetit, por nuk ka të gjetura dhe as rekomandime.

10. Informatë e DKA-së për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/2024;

Avni Morina: Faleminderit i nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, anëtarë të kuvendit, kolegë. Do të mundohem në mënyrë telegrafike të paraqes disa prej aktiviteteve që i kemi zhvilluar gjatë gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/2024. Gjatë kësaj periudhe kemi kryer disa punë dhe kemi zhvilluar disa aktivitete: Pas riparimit dhe punimeve në projektin e eficiencës, në objektin e shkollës “Rilindja” në Çifllak është bërë riparimi i kulmit të ndërtesës. Në objektin e shkollës në Sapniq ka përfunduar ndarja fizike e tre klasëve dhe janë krijuar kushtet që nxënësit e kësaj shkolle të mbajnë mësim vetëm në një ndërrim. Atëherë, nëse nuk ka nevojë që ta lexoj deri në fund, nëse keni ndonjë pyetje, urdhëroni.

Edona Kryeziu: I nderuar kryesues, kryetar, të nderuar kolegë. Fillimisht kërkoj mirëkuptimin e drejtorit, sepse personalisht jam kritikuar që po merrem në secilën seancën me Drejtorinë e Arsimit, por sinqerisht nuk mund t'i anashkaloj shkeljet që bëhen në këtë drejtori. Dua të ndërlidhem tek informata e DKA-së për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/2024. Në fillim thuhet kemi zhvilluar disa aktivitete, kur të shikohet brendësia e aktiviteteve del që janë shumë pak. Sipas mendimit tim kjo informata është tepër e mangët dhe joinformuese. Në asnjë pikë të kësaj informata nuk vërejtja që kemi informacione për mosvijueshmërinë e fëmijëve në shkolla, aksidentet nëpër shkolla dhe ajo që më bëri përshtypje, askund nuk e pashë që keni pranuar mësimdhënës të rinj.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, drejtorë, kolegë. Te informata për përfundimin gjysmëvjetorin të parë të këtij viti shkollor, vetëm dua ta pyes drejtorin te çështja e tabelave digjitale, që është investim i komunës nëpër shkollat e Komunës së Rahovecit. Nuk e di specifikisht në cilat shkolla janë dorëzuar këto investime, por pse nuk janë ende funksionale? Gjithashtu, dua ta pyes drejtorin se a ka probleme në raportet në mes profesorëve dhe nxënësve, sidomos në shkollat e mesme?

Hasan Përboqi: Faleminderit kryesues! Po e ngris një shqetësim që ndoshta nuk lidhet direkt me arsimin, por është bashkëpunim. Kohëve të fundi në klasat 1-5 është paraqitur sëmundja e Zgjedbës, e kemi një rast në komunën fqinj të Gjakovës, vetëm në një shkollë janë 14 raste. Sëmundja e Zgjedbës është sëmundje ngjitëse dhe zgjatë deri në 4 javë. Kërkoj nga Drejtoria e Shëndetësisë së bashku me Drejtorinë e Arsimit t'i formojnë disa ekipe dhe të dalin në terren të shikojnë se a kemi raste të tilla në komunën tonë.

Avni Morina: Faleminderit kryesues! Faleminderit edhe për pyetjet! Ne, gjatë vitit që shkoi i kemi furnizuar shkollat me 20 tabela digjitale (20 shkolla nga një), aq sa kemi pasur mundësi dhe buxhet. Të gjitha tabelat që i kemi dërguar nëpër shkolla janë funksionale. Sa i përket problemeve ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve, deri më sot nuk kemi pasur ndonjë raport që ka ndodhur ndonjë eksels i tillë. Në komunën tonë deri më tani nuk kemi pasur ndonjë rast të

raportuar sa i përket sëmundjes së Zgjedhës. Ne jemi në kontakt me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe vizitat sistematike mjekësore tek nxënësit, sidomos te cikli i ulët do të vazhdojnë. Edona ndoshta nuk bëri pyetje, por bëri konstatime më shumë. Jam munduar t'i pasqyroj të gjitha aktivitetet që i kemi pasur nga shtatori deri në fund të gjysmëvjetorit të parë.

11. Informatë mbi kontratat publike të Komunës së Rahovecit;

Kryetari: Meqenëse këtë informatë e ka paraqitur përgjegjësi i Zyrës së Prokurimit, Astrit Mullabazi dhe ai është sot në kolegjiunin e zyrtarëve të prokurimit në shkallë vendi. Ju e keni materialin afër dhe ne mund ta diskutojmë, por nëse keni ndonjë pyetje, mund të rezervoheni që në seancën e ardhshme të parashtroni pyetje në pikën e dytë të rendit të ditës.

Burim Krasniqi: E pata vetëm një kërkesë ose vëmendje të Drejtorisë e Financave, meqenëse ndërlidhet me Zyrën e Prokurimit. Drejtor, vlera e paraparë e kontratave që janë lidhur në 2023, me vlerën e kontratave të lidhura dallon për 23%, pra, 23% më shumë buxhet është paraparë se sa që janë lidhur kontratat. Mirë është të jeni më të kujdesshëm që vlera e kontratave të përafrohet më shumë me vlerën e ofertave. Kontratat janë paraparë 16milion dhe janë lidhur 13milion, në rregull që janë lidhur më lirë, por të përafrohet planifikimi deri në 10/15%.

Leonard Morina: Atëherë, meqenëse po mbetet te pyetjet dhe përgjigjet për seancën e radhës, kisha thënë që është mirë që Astrit Mullabazi të jetë prezent, për shkak pyetjeve që i kemi.

Kryetari: Përgjigje më profesionale do të merrni nga Astriti. Ju përkujtoj faktin që edhe në prokurim nga matjet që i ka bërë USAID-i, fatbardhësisht kemi shënuar avantazh te ai 23%. Tentativat që t'i ofrohem më shumë vlerave të parashikuara të kontratave është sfidë dhe qëllim i përbashkët.

12. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-02302-1 dhe 02299-0, zk-Rahovec;

Kryesuesi: Ky komision formohet për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë deri në 25 vite të pronës së paluajtshme të komunës. Kemi dy anëtarë nga ekzekutivi, dy nga kuvendi i komunës.

Hasan Përboqi: AAK, Feriz Thaqi.

Leonard Morina: LVV, Ilir Pallqa.

Burim Krasniqi: LDK, nuk ka propozim.

Bejtullah Deliu: PDK, Sejfullah Sejfullahu.

Kryetari: Nga ekzekutivi propozoj Afrim Oruqi dhe Besmirë Bytyqi, ndërsa nga shoqëria civile do të jetë një e gjinisë femrore.

Kryetari: Atëherë, nëse jeni dakord me mirëkuptim kërkoj që njëri të tërhiqet, në këtë rast Feriz Thaqi.

Kryesuesi: Atëherë, përbërja e komisionit nga kuvendit është kjo: Ilir Pallqa nga Vetëvendosja, Sejfullah Sejfullahu nga PDK, nga ekzekutivi Besmire Bytyqi dhe Afrim Oruqi, si dhe një përfaqes nga sektori joqeveritar. E kalojmë në votim, kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash votohet kjo përbërje e komisionit. Ju falënderoj për vëmendje, shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

K R Y E S U E S I

Arbër Zenuni



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesje Sociale

Odeljenje za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu

Department of Health and Social Welfare

Datë/Datum/Date:	13.03.2024
Referenc-ë	
Për/Za/To:	KPF dhe Kuvendi Komunal
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	Znj.Saranda Sallteku, Drejtoreshë e DSHPS-së Rahovec
Subjekti/Predmet/Subject:	Informatë për Planin për Banim Social

I/e nderuar,

Kjo informatë rrjedhë nga Programi Komunal Trevjeçar për Banim 2022-2025, plan i cili është aprovuar nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit me datën 28.10.2022.

Periodha raportuese për këtë informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesje Sociale sa i përket Planit për Banim Social është janar – dhjetor 2023.

Kërkesat për Banim Social, drejtuar Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje sociale kanë qenë 13.

Pas verifikimit të kërkesave dhe dokumentacioneve të nevojshme nga zyrtarët përgjegjës të kësaj drejtorie, janë përzgjedhur 4 familje për t'i mbështetur me strehim të përkohshëm.

Kostoja financiare e këtyre 4 familjeve të cilët kanë përfituar strehim të përkohshëm ka qenë në vlerë 600.00 € në muaj.

Me respekt;

Saranda Sallteku



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam Department of Economy, Development and Tourism

DATË /A:	15.3.2024
PËR/ZA/TO :	Arbër Zenuni, kryesues i Kuvendit Komunal
NGA/OD/FROM:	Erhan Morina, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë mbi menaxhimin e aseteve komunale për vitin 2023

Me propozim të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, drejtuar kryetarit të Komunës

Smajl Latifi, janë formuar këto komisione lidhur me pasuritë e Komunës së Rahovecit:

- Komisioni për regjistrimin e pasurive jofinanciare;
- Komisioni për inventarizimin e pasurive jofinanciare;
- Komisioni për tjetërsimin e pasurive jofinanciare;
- Komisioni për asgjësimin e pasurive jofinanciare.

Të gjitha komisionet e formuara me vendim, i kanë kryer punët me kohë, duke filluar nga procesi i regjistrimit të aseteve, inventarizimi, kurse gjatë vitit 2023, nuk ka pasur tjetërsim dhe asgjësim të aseteve.

-Në fund të vitit 2023, komisioni e ka kryer inventarizimin e pasurive jofinanciare në objektet e administratës, objektet e arsimit (në shkolla), QKMF dhe Objektet përcjellëse, ku në raportin përfundimtar të tyre ka konstatuar se janë gjithsej 709 asete jashtë përdorimit.

-Komisioni i regjistrimit ka përfunduar regjistrimet dhe ka evidentuar në administratë komunale, objektet kulturore dhe sportive, gjithsej 7,306 asete, në shkolla ka evidentuar 21,303 asete, kurse në QKMF, QMF dhe AMF 1,834 asete.

-Gjatë vitit 2023, janë shitur përmes ankandit publik asetet e papërdorura të komunës duke përfshirë: Stufa të dëmtuara të shkollave, kaldaja, dritare të dëmtuara, karrige të dëmtuara dhe banka shkollore, të gjitha këto në vlerë 800€. Po ashtu, në këtë ankand publik, janë shitur dhe 4 vetura të cilat kanë qenë jashtë përdorimit, në vlerë 4,100.00€, si dhe një kamionin me rimorkio, në vlerë 8,050.00€.

Totali i aseteve të shitura në këtë ankand është 12,950.00€

Regjistrimet mbi 1000€ dhe më pak se 1000€ gjatë vitit 2023

Nr.	Përshkrimi	Numri i regjistrimeve	Vlera
1	Regjistrimet mbi 1000.00€	304	16,358,637.41€
2	Regjistrimet nën 1000.00€	123	59,251,75 €
TOTAL		427	16,417,889.16 €

Asetet e regjistruara në vlerë nën 1000€, sipas kodeve, nga data 1.1.2000 - 31.12.2023, që janë të regjistruara në programin e-pasuria.

Nr.	Nënkategoria	Përshkrimi	Vlera në libër
	13501	Mobile	152,567.63 €
	13503	Pajisje të teknologjisë informative-TIK	96,570.63 €
	13506	Pajisje mjekësore	36,199.87 €
	13509	Pajisjet e tjera	28,211.00 €
Gjithsej:			313,549.13

Sa u përket regjistrimeve në vlerën mbi 1,000€, sipas klasave të pasurisë, të regjistruara nga viti 2000-2023, në programin SIMFK:

	Përshkrimi	Kodi	Vlera neto në libër
1	Objekte arsimore	31121	15,391,511.75 €
2	Objekte sportive	31124	2,256,380.52 €
3	Objekte kulturore	31123	1,704,832.70 €
4	Vetura të ndihmës së shpejtë	31703	171,785.00 €
5	Pajisje speciale mjekësore	31660	8,354.93 €
6	Objekte shëndetësore	31122	3,420,732.32 €
7	Kapitale të tjera	31900	658,194.16 €
8	Kamion	31701	7,772.25 €
9	Kanalizim	31250	1,745,055.37 €
10	Ndërtimi i rrugëve	31200	397,100.84 €
11	Tokat	32100	75,104,323.90 €
12	Pajisjet e tjera	31690	9,900.47 €
13	Ujësjiellës	31400	701,732.55 €
14	Trotualet	31240	325,274.76 €

15	Ndërtimi i rrugëve lokale	31230	4,834,541.18 €
16	Ndërtesat banesore	31110	7,272,302.04 €
17	Ndërtimi i rrugëve regjionale	31220	44,467.50 €
18	Investimet në vijim	32500	21,660,786.00 €
19	Veturat zyrtare	31706	- €
20	Automjet transporti	31700	- €
21	Furnizim me rrymë-gjenerator	31510	12,337.66 €
22	Struktura të tjera	31130	2,319,914.89 €
23	Ndërtesa e administratës afariste	31120	6,564,116.71 €
		TOTALI	144,611,417.50



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec - Opštine Orahovac
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Odeljenje za Geodeziju, Katastar i Imovinu



Komuna e Rahovecit
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre

Komuna e Rahovecit është e përbërë nga 34 Zona Kadastrale në të cilën janë të shpërndara paluajtshmërit në të gjitha zonat kadastrale. Në këtë raport janë të përfshira edhe objektet e QKMF-së, shkollat fillore, shkollat e mesme, çerdhet, palestrat sportive, objektet kulturore, objektet e komunës, më poshtë tabelari me të dhëna më të hollësishme:

	Objektet:	Sipërfaqja:
1.	Shkollat	44850 m ²
2.	Shkollat Profesionale	6500 m ²
3.	Çerdhet	1057 m ²
4.	Objektet Kulturore	5752 m ²
5.	Palestrat Sportive	3225 m ²
6.	QKMF-të	7587 m ²
7.	Objektet Komunale	1313 m ²
		70284 m²

	Zonat Kadastrale:	Sipërfaqja:
1.	Rahovec	1727960 m ²
2.	Brestovc	291840 m ²
3.	Hoçë e Vogël	531923 m ²
4.	Nagavc	292140 m ²
5.	Retijë	623607 m ²
6.	Zoqishtë	126183 m ²
7.	Opterushë	498706 m ²
8.	Hoçë e Madhe	383781 m ²
9.	Celinë	539527 m ²
10.	Krushë e Madhe	1989796 m ²
11.	Xërxë	162249 m ²
12.	Bellacërkë	390836 m ²
13.	Sapniq	60726 m ²
14.	Nushpall	34202 m ²

KOMUNA RAHOVEC

15.	Zatriq	166451 m ²
16.	Potoqan i Poshtëm	126986 m ²
17.	Drenoc	232267 m ²
18.	Senoc	89864 m ²
19.	Gexhë	284026 m ²
20.	Pastasellë	95374 m ²
21.	Polluzhë	57047 m ²
22.	Radostë	402062 m ²
23.	Ratkoc	355235 m ²
24.	Vrajak	166214 m ²
25.	Dejnë	214800 m ²
26.	Bratotin	111990 m ²
27.	Guri i Kuq	201556 m ²
28.	Mrasor	207945 m ²
29.	Kaznik	501406 m ²
30.	Çifllak	311379 m ²
31.	Dobidol	295113 m ²
32.	Kramovik	389830 m ²
33.	Bërnjak	23192 m ²
34.	Potoqan i Epërm	25762 m ²
		1191,19.75

Vërejtje:

Këto të dhëna mundë të ndryshojnë për arsye se mund të ketë ndryshme në Sistemin Informativ i Kadastrit të Tokave të Kosovës – SIKTK.

Më datë:

05/03/2024

Afrim Oruqi

Drejtor për G.J.K.P

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Adresa: 8 Dëshmorët e Pashtrikut, p.n. Rahovec, Kosovë
Centrix: 45341
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*”), nenit 74 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës i:

PROPOZON

1. Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit të futbollit në Rahovec.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij propozimi do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510006-00231-8 me sipërfaqe të përgjithshme prej 35000m² (tridhjetë e pesë mijë metra katror), Zona Kadastrale Bërnjak, në vendin e quajtur Palatica, e evidentuar në emër të Komuna e Rahovecit.
3. Parcela e cekur në pikën 2 të këtij propozimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2023-2031 me Nr. Prot. 01 Nr. 182/24 i datës 30.01.2024 ka destinim Tokë Ndërtimore.
4. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë nga donatorët e ndërtimit të objektit
5. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Sekretaria e Kuvendit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.

Me propozim të njoftohen:

1. ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
2. ***Sekretaria e Kuvendit, dhe***
3. ***Arkivi.***

Smajl Latifi

Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Nr. 01-2024
Datë: 18.03.2024

RAPORTI VJETOR I PUNËS I KOMITETIT TË AUDITIMIT 2023

Nga: Sehad Boshnjaku, Kryesues i Komitetit të Auditimit

Për: Kryesuesin e Kuvendit Komunal të Komunës së Rahovecit
CC: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa

RAHOVEC, Mars 2024

Për periudhën raportuese, Komiteti i Auditimit ka shqyrtuar raportet e Auditimit të Brendshëm dhe raportin vjetor të Auditorit Gjeneral për vitin 2023.

Gjithashtu, Komiteti i Auditimit ka mbajtur pesë seanca ku janë shqyrtuar pikët të ndryshme sipas programit dhe planin e punës për vitin 2023.

Në të gjitha takimet janë mbajtur procesverbale ku janë regjistruar të gjitha diskutimet e anëtarëve të komitetit të Auditimit dhe drejtorët e drejtorive përkatëse, pjesëmarrës në këto takime. Po ashtu në shumicën e seancave ka marrë pjesë drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z. Afrim Limani. Gjithashtu, në procesverbalet e takimeve janë nxjerrë konkluda nga këto takime të cilat u janë rekomanduar drejtorive komunale për veprim.

1. Seanca e parë

Është mbajtur më 07.03.2023 me këto pika të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Brendshëm për drejtorinë për Financa dhe Buxhet;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Brendshëm për Zyrën e Prokurimit;
4. Të ndryshme;

Në këtë takim kanë diskutuar; Sehad Boshnjaku, Kryesues i Komitetit, Aferdita Zena Anëtar i Komitetit, Blerina Kabashi Antar i Komitetit, Skender Hamza, Anëtar i Komitetit, Mirsad Shala, Anëtar i Komitetit, Drejtori i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, z.Afrim Limani , si dhe Auditor i njësisë së Auditimit të brendshëm Ruzhdi Kabashi.

Kryesuesi: Nëse jeni të pajtimit dhe meqë është i pranishëm përfaqësuesi i Zyrës së Prokurimit, kalojmë te pika e tretë për diskutim.

Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Brendshëm për Zyrën e Prokurimit;

Kryesuesi: Qëllimi dhe fushëveprimi në kryerjen e auditimit, i cili do t'i ofrojë zyrtarit përgjegjës të prokurimit, informata të mjaftueshme dhe të dobishme rreth operacioneve të aktivitetit dhe efikasitetit të sistemit të menaxhmentit dhe të procedurave të prokurimit të vitit kontabël, 1 janar 2022 dhe 30 dhjetor 2022. Çështja 1: Pas leximit të këtij raporti nga ana ime, është vërejtur se asnjë rekomandim nuk është kthyer nga Zyra e Prokurimit se kur do të fillojë së zbatuari. Gjetje: Ne kemi pritur që menaxhmenti i Zyrës së Prokurimit dhe zyrtarët përgjegjës të ndërmarrin veprime të duhura për implementimin e rekomandimeve, sipas planeve të veprimit për raportet e viteve paraprake. Në raportet paraprake, njësia e auditimit të

brendshëm, kishte dhënë 5 rekomandime dhe menaxhmenti i zyrës së prokurimit nuk kishte përgatitur Planin e Veprimit, dhe me këtë rast nuk kemi mundur të bëjmë një vlerësim të progresit të rekomandimeve. Konkluzioni: Moszbatimi i rekomandimeve, ndikon në përsëritjen e rekomandimeve të njëjta dhe e rrit rrezikun në mospajtueshmërinë e procedurave të prokurimit sipas ligjeve. Rekomandimi: i rekomandojmë menaxhmentit të Zyrës së Prokurimit të respektohen hapat e përcaktuara me rregullat në fuqi dhe në të ardhmen të bëjë gati planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve. Të njëjtën pyetje e kam për zyrtarin e prokurimit se kur do të përgatitet plani?...

Astrit Mullabazi: Faleminderit! Sa i përket raportit të auditimit për 2021 të mbajtur në 2022, te raporti i auditimit, ka qenë që raporti i vlerësimit të tenderëve duhet të kryhet brenda 5 ditëve dhe mendoj që nuk ka ndonjë plan të zbatimit të atij raporti, sepse raporti i vlerësimit bëhet sipas ligjit në fuqi. Nuk e kam bërë planin e zbatimit të rekomandimeve, sepse nuk e di se çfarë plani duhet bërë.

Ruzhdi Kabashi: Përsëritet! Çështja ka qenë se nuk ka afat të cekur prej 5 ditësh, por afati për procedura ka qenë 3 ditë, por këta kanë shkuar deri në 35 ditë, 5 ditë më tepër sesa e lejon ligji.

Astrit Mullabazi: Afati minimal i lejuar, sipas ligjit, është 30 ditë, por në raste komplekse, te tenderët me vlerë të madhe, mund të vazhdohet edhe plus 20 ditë të tjera.

Ruzhdi Kabashi: Është e vërtetë, por duhet të ketë arsyeshmëri.

Skender Hamza: Përsëritet për të gjithë! Te rishikimi i zbatimit të rekomandimeve nga auditimi, ku thotë: në Raportin e Auditimit, Njësia e Auditimit të Brendshëm, kishte dhënë 5 rekomandime, menaxheri i zyrës së prokurimit nuk kishte përgatitur Planin e Veprimit, prej 5 rekomandimeve, asnjë Plan të Veprimit. Arsyeja që nuk e keni ditur se çfarë plani ta bëni dhe nuk e keni bërë, nuk është arsye. Së paku, është dashur ta bëni një arsye me shkrim. Tjetra, në raportin vjetor për kontratat e nënshkruara publike, përveç shumës së të dhënave që kërkohet të plotësohet, ekziston edhe rubrika ku kërkohet të shënohen pagesat e bëra për çdo kontratë veç e veç dhe në këtë raport nuk ka asnjë të dhënë për pagesat e bëra. Nuk e di sa është e lejuar që kjo të ndodhë, por ne si komitet duhet që çdo muaj, Kryetarit të Komunës t'i raportojmë dhe të ai jetë i njoftuar me rekomandimet e komitetit për të gjeturat që i kemi.

Blerinë Kabashi: Desha të lidhem te pika e 4-të, ku thotë: Mungesë e bashkëpunimit për ofrimin e dokumenteve të kërkuara për auditim. Me çfarë qëllimi është bërë kjo?...

Astrit Mullabazi: Zyra e Prokurimit, në sistemin e prokurimit elektronik (E- prokurimi), ka qasje si përdorues, Ruzhdi Kabashi e ka rolin e monitoruesit të brendshëm për përcjellje të aktiviteteve të prokurimit. Megjithatë, ne kemi qenë të hapur duhet i ofruar të gjitha dokumentet e kërkuara brenda suazave ligjore, dokumentet e tjera nuk janë në kompetencë të Zyrës së Prokurimit.

Ruzhdi Kabashi: Raporti i pagesave, që është cekur si e gjetur, është një raport standard që paraqiten lidhjet e kontratave, shumën etj... Te ky raport është dhe te asnjëra nga kontratat nuk e ka shumën për punët e kryera. Te dokumentacioni i kërkuar, janë kërkuar pesë lloje të dokumenteve, dy prej tyre janë

siguruar dhe 3 të tjera jo. Sa i përket çështjes së E-prokurimit, është e vërtetë që kam qasje, po ka raste që kam të drejtë mos t'i besoj E-prokurimit me dokumente të skanuara dhe e kërkoj një origjinal. E drejta e auditorit është të bëjë krahasime, barazime, verifikime etj...

Mirsad Shala: Faleminderit kryesues! Jemi duke e bërë një diskutim të kotë, përderisa në fund është një plan i veprimit të menaxhmentit dhe në procesverbal do të ceket që në plan të veprimit nuk është plotësuar rubrika nga Zyra e Prokurimit. Te rekomandimi i 4-të, është dashur të shënohet që është i zbatueshëm, sepse në të ardhmen mund të pajiset me dokumente përcjellëse të kërkuara.

1. Seanca e dytë

Është mbajtur më 28.08.202 me këto pika të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Brendshëm në Drejtorin për Financa dhe Buxhet;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Brendshëm në Drejtorin për Shërbime Publike Komunale;
4. Të ndryshme.

Në këtë takim kanë diskutuar; Sehad Boshnjaku, Kryesues i Komitetit, Aferdita Zena Anëtar i Komitetit, Blerina Kabashi Antar i Komitetit, Skender Hamza, Anëtar i Komitetit, Mirsad Shala, Anëtar i Komitetit, Drejtori i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, z.Afrim Limani, si dhe Auditor i njësisë së Auditimit të brendshëm Ruzhdi Kabashi.

Kryesuesi - Përhëndetje për të gjithë të pranishmit, nëse jeni të gatshëm t'ia fillojmë me mbledhjen e dytë të këtij vitit, po ja filloj me rendin e ditës, pika 1, shqyrtimin dhe aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, pika 2, shqyrtimi i raportit të auditimit të brendshëm për Drejtorinë Financë dhe Buxhet, pika 3, shqyrtimi i auditimit të brendshëm për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe e fundit pika 4, të ndryshme. Shpresoj që të gjithë i keni materialet, i keni pranuar edhe materialet e fundit, në qoftë se jeni të pajtimit që që ta qesim në votim rendin e ditë, kush është për, kundër, abstenim, konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja kaluar, konstatoj që edhe pika e parë është aprovuar unanimisht. Kalojmë në pikën e dytë rendit të ditës,

1. Shqyrtimi raportit të Auditimit të Brendshëm për Drejtorinë Financa dhe Buxhet.

Fushëveprimi i raportit të auditimit është për periudhën janar-tetor të vitit 2022. Objektivat e këtij raporti është inkasimi dhe realizimi i mjeteve, shpenzimet, barazimi i harmonizimit i të hyrave në raport me zyrtarin e të hyrave komunale dhe taksat për automjete. Inkasimi dhe realizimi në tatimin pronë. Bazat e hyrave si taksë vjetore komunale përmban tatimin në pronë. Tatimi në pronë aplikohet për të gjithë pronat e paluajtshme mbi apo nën sipërfaqen tokësore përcaktohet nga shumëzimi i vlerës tatimore në pronë me normë tatimore të

aplikueshme. Shkojmë te çështje një gjetje. Numri i faturave të shpërndara për vitin 2022, ishte 12.504, kurse vlera financiare ishte 637,160.03 €. Regjistrimet e reja ishin 632 objekte në sipërfaqe prej 115.028 m/2. Verifikimet e objekteve ishin 3.165 objekte në sipërfaqe prej 527.501 m/2. Numri i faturave të shpërndara për vitin 2021 ishte 13.320. Regjistrime të reja në vitin 2021 ishte 371 objekte në sipërfaqe prej 65.296 m/2. Verifikimet e objekteve ishin 2.768 objekte në sipërfaqe prej 434.398 dha ma pak fature për 816. Regjistrimet e reja ishin më shumë për 261, kurse verifikimi i objekteve ishte bërë më shumë për 397. Kalojmë tek rekomandimi numër një. Rekomandojmë Drejtorinë për Financa Buxhet të caktojë planifikimin real, krahasuar me vlerën e faturuar dhe të mbajë evidencë të plotë dhe të saktë mbi të hyrat. Rekomandohet Departamenti i Buxhetit që në të ardhmen t'i ketë parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshirë edhe historikun e realizimit të hyrave gjatë viteve paraprake. Nga të pranishmit, a ka dikush që do të ndërhyjë për ndonjë pikë apo rekomandim?

Skender Hamza -Përsëritet kryesues! Drejtori nuk është prezent të na jepe një sqarim. Po kam disa paqartësi, për shembull, thotë në vitin 2021 janë shpërndarë më shumë fatura sesa në vitin 2022. Ku është arsyeja. Poashtu më pak se në vitin 2021 edhe plus që regjistrimi ka shtesë më shumë, kurse faturat më pak janë shpërndarë. Nëse sa i përket tatimit në pronë, tash kjo është ajo që kisha dashtë një përgjigje, po drejtoritë nuk janë këtu prezentë. Pastaj edhe te këto rekomandimet që i kanë dhënë. Po tash na edhe nëse bëjmë pyetje nuk besoj që dikush është këtu që mund me na dhënë ndonjë përgjigje.

Kryesuesi - Faleminderit, Skender! Me të vërtetë është një pyetje që do të ishte bërë prej të gjithëve, po edhe ne si Komitet, edhe si anëtarë të Komitetit të Auditimit të Brendshëm, rekomandojmë që me perpilu një listë edhe me këto gjetje që janë, t'i të kërkohet edhe prej Auditorit të Brendshëm, zotit Kabashi, që të bisedoj edhe një herë me drejtorinë përkatëse, në qoftë se jo, si në procesverbal duhet të futet edhe kjo ky rekomandim, në qoftë se jo ë duhet t'i drejtohem edhe kryetarit nëpërmjet të auditorit, domethënë Ruzhdisë. Edhe te rekomandimet, po të ishte drejtori në fjalë, do të kisha bërë për pyetjen për rekomandimin numër dy, që thotë ë rekomandojmë për Drejtorin Financa dhe Buxhet si dhe menaxherin e Zyrës së Tatimit në pronë që menjëherë të përdorë mekanizmat ligjorë që përmes përfaqësuesit ligjorë të komunës të iniciojë procedurë përmbartimore për rikthimin e detyrueshëm të borxheve. Rekomandohet drejtori i drejtorisë se duhet shtuar kontrole të brendshme në Departamentin e Tatimit në pronë dhe të shtohen burimet njerëzore adekuate në këtë departament.

Skender Hamza - Tash tek Tatimi në pronë, domethënë ky është raport i vitit 2022. Kurse tatimi në pronë i vitit 2023 në Komunën e Rahovecit ka dalë, domethënë brenda periudhës tash sa jemi tetë mujore ka tejkaluar. Tash tatimi në pronë këtë vit ka qene i realizuar. Ne e kemi pas në Kuvend arsyen pse është realizuar e ka dhënë drejtori, mund me qenë edhe për shkak që prej ministrisë është ritur me u rritë tatimi në pronë njëqind për qind dhe njerëzit janë detyruar që ta paguajnë nga frika e rritjes së tatimit në pronë, Unë mendoj që ky rekomandim është realizu te tatimi në pronë.

Afërdita - Ky rekomandim numër dy që thotë me e angazhu një person si zyrtar për inkasim të detyrueshëm. Unë e kisha pyet për shembull a kanë filluar këta që ta zbatojnë? A kanë menduar që duhet realisht me pas një zyrtar tamam për inkasimin e shtimin e borxheve? Po, e njëjta pyetje është që data e planifikimit për përfundim këtu është cekë edhe është planifikuar që me datën 30.05.2023, të përfundojë ky rekomandim në sektorin tatimit të pronë dhe sektorin për buxhet e financa.

Skender Hamza – Siq jemi duke parë është përmbush inkasimi i mjeteve, po këtu tek rekomandimet nr.2 i kemi i kemi dy pyetje që është rekomandohet drejtori i drejtorisë se duhet shtuar kontroll të brendshëm në Departamentin e Tatimit të Pronë dhe të shtohen burimet njerëzore adekuate në këtë departament, departamenti i tatimit në pronë të ketë zyrtarin për inkasimin. Shpresoj edhe uroj që me 30.05.2023 veç është

përfunduar. Ndoshta edhe ndonjë zyrtar është i caktuar nga drejtori i kësaj drejtorie që t'i inicioj rastet për mbledhjen e tatimit në pronë. Faleminderit!

Kryesuesi - Ka dikush edhe ndonjë paqartësi për këtë raport? Nëse jo e kalojmë në pikën e radhës.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Brendshëm në Drejtorin për Shërbime Publike Komunale

Qëllim ynë është të kryejmë një auditim, i cili do të ofrojë menaxhmentit të Drejtorisë një informata të dobishme, rreth operacioneve tuaja dhe efikasitetin e sistemeve që ju operoni. Komunikimi i hapur me ju është i rëndësishëm për suksesin e auditimit. Fushëveprimi i auditimit është për periudhën prill dhjetor 2022 dhe janar-mars të vitit 2023, duke u përfshirë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me identifikimin e të hyrave, regjistrimeve, evidentimet, pagesat dhe barazimet. Objektivat janë. inkasimi dhe realizimi të hyrave vetanake, taksat komunale për vendosjen e përkohshme të objekteve të ndryshme në hapësira publike, si kioska dhe të tjera taksat për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike për kryerjen e veprimtarisë së tyre, subjektet afariste të regjistruara, taksat për dhënie me qira hapësirës publike dhe aseteve nëntokësore për shfrytëzim. Kalojmë tek çështje numër një. Këta janë sipas Rregullores për taksë komunale. Besoj që jeni të gjithë të njoftuar. Kisha kalu tek për periudha janar-mars 2023, pasi që viti fiskal për 2022 veç ka përfunduar, edhe pasi jemi në vitin adekuat, domethënë 2023 mundemi me i diskutu këtë periudhë. Realizimi i të hyrave për periudhën janar-mars të vitit 2023 ishte në shumë prej 3,861.45 €, apo 31.12 % të buxhetit të planifikuar prej 10.800 €. Kurse gjatë realizimit i të dhënave kemi bërë një krahasim për periudhën e njëjtë të vitit paraprak 2022 dhe kemi vërejtur se në aspektin e përgjithshëm ka pasur një rritje të të hyrave janar-mars 2023. Është për të uruar, në periudhën paraprake 2022 ishte inkasuar të hyra në vlerë prej 2,821.00 €, kurse gjatë periudhës 2023 ishin inkasuar po ata mjetet prej 3,861.45 €. Krahasuar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak janë inkasuar të hyra në shumën prej 540.45.00 €. Trendi i argëtimit ndaj planifikimit në periudhën janar-mars 2023 vërehet një rritje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjatë realizimit të të dhënave për vitin 2022, vërejmë se nuk ka pasur një planifikim shumë me mundësinë reale të të hyrave. Shuma e planifikuar ishte 12,150.00 €, ndërsa realizimi i të hyrave ishte 18,100.00 €, apo 100% që i bie e paska tejkaluar për 7.82 %.

Skender Hamza - Vetëm këtë rekomandim e kisha mbështetë si anëtar i këtij Komiteti rekomandimin që e ka dhënë auditori i brendshëm, ku e cek që e rekomandojmë Drejtorin e Audituar duhet të sigurojë se performanca e mbledhjes së të hyrave të monitorohet dhe të rishikohet në mënyrë sistematike. Ne e shohim që këtu për shembull ka periudha që zero është, pastaj në fund të vitit mund me inkasu një mijë, dy mijë, tre mijë euro, po brenda mënyrë sistematike nuk kemi të hyra në këtë Drejtori. E kemi këtë tabelarin për shembull s'ka hiç, pastaj është një periudhë ku ka të hyra, domethënë dy-tre mijë euro, por është periudha ndoshta shtatë-tetë muaj, nëntë muaj nuk ka asnjë të hyrë. Kështu që e mbështes rekomandimin që ka dhënë Auditori i Brendshëm.

Kryesuesi - Kalojmë tek taksat komunale për vendosjen e objekteve të përkohshme të ndryshme në hapësirat publike. Edhe kjo është për vitin 2022, kështu që kjo periudhë veç ka kaluar, në qoftë se jeni të pajtimit që ta kalojmë, edhe ashtu jemi në tetë mujorëshin e fundit apo nëntë mujorëshin,

Skender Hamza - Isha ndërlidhur tek rekomandimi numër dy, ose konkluzioni. E dimë që shpeshherë, ose gjithmonë, ka neglizhencë të procedurave të kontratave lidhur me objektet e përkohshme të Komunës së Rahovecit, siç janë, për shembull, skadon kontrata ndoshta pesë, gjashtë muaj, shtatë, tetë muaj pa kontratë punojnë. Kështu që edhe rekomandimin që e ka dhënë që Drejtorisë Shërbimit Publike t'i siguroj kontrata kontraktuesit lidhur me kontratat në kohë dhe afat të përcaktuar, që t'i qëndrojnë në afate, realisht të njoftohen këta që i kanë objektet e parakohshme një muaj, dy muaj para kohe që i skadon kontrata, që të jenë me afat për lidhjen e kontratës së re.

Kryesuesi - Kështu mundet të jetë edhe një shtim tek rekomandimi një edhe prej anës së anëtarëve të Komitetit të Auditimit që në të ardhmen të përcaktohet një fiks kohë pas periudhës nëntë mujore, në qoftë se është një kontratë në dymbëdhjetë muaj, mbas përfundimit të muajit nëntë, muaji i dhjetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, të jenë të informuar të gjitha qiramarrësit ose për shfrytëzuesit e pronave publike në mënyrë sistematike për çdo muaj të njoftohen edhe shfrytëzuesit që të lidhet edhe kontrata në afat më të shpejtë. Po e diskutojmë edhe rekomandimin numër tre, të rekomandojmë Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtorin për Punën Inspektuese Inspektorin e Ndërtimit që të ndërmarrin masat e menjëhershme për largimin ose mbylljen e objekteve neni nëntëmbëdhjetë si dhe ekzekutimin e vendimeve për zbatimin e nenit njëzet e pesë në dispozitën ndëshkuese të Rregullores, Skënder, kemi diçka të ky rekomandim?

Skender Hamza - Kjo është ajo që e dhashë te konkluzioni numër dy, e njëjtë është që mos të ketë neglizhim të procedurave, s'ka ndëshkuese ndaj atyre. Kështu që, shpeshherë na e dimë, siç e thashë edhe më përpara, kalojnë pesë-gjashtë muaj, ndoshta edhe një vit, ata veç vazhdojnë, i kanë pronat në shfrytëzim e nuk paguajnë asgjë komunës.

Kryesuesi - Ashtu është Skender edhe ne qëndrojmë mbrapa, si anëtarë të Komitetit të Auditimit, në rekomandimin që e ka dhënë auditori i Komunës së Rahovecit. Në qoftë se nuk keni edhe diçka për pikën tretë të rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e katërt.

4. Të ndryshmet.

Tek pika e katërt e rendit të ditës të ndryshme, unë si kryesues i Komitetit të Auditimit të Brendshëm, njoftoj anëtarët e Komitetit që mbas një bisede me drejtorin, më ka njoftuar që pagesa do të bëhen, ndoshta pak është me vonesë, po nuk është çështje te Komuna e Rahovecit, po është tek Ministria e Financave. Kështu që, shpresojmë sa më shpejtë edhe të bëhet edhe pagesa për anëtarët. Ju faleminderit të gjithëve për mbledhjen e sotit e shpallim të mbyllur. Shihemi në mbledhjet e ardhshme.

2. Seanca e tretë

Është mbajtur më 09.11.2023 me këto pika të rendit të ditës:

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Brendshëm për Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Brendshëm për Drejtorin për Administratë të Përgjithshme;**
- 4. Te ndryshme;**

Në këtë takim kanë diskutuar; Sehad Boshnjaku, Kryesues i Komitetit, Aferdita Zena Anëtar i Komitetit, Blerina Kabashi Antar i Komitetit, Skender Hamza, Anëtar i Komitetit, Mirsad Shala, Anëtar i Komitetit, Drejtori i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, z.Afrim Limani, si dhe Auditor i njësisë së Auditimit të brendshëm Ruzhdi Kabashi.

Kryesuesi - A ka dikush të shtojë diçka sa i përket rendi të ditës, nëse jo atëherë e qes në votim. Konstatohet se unanimisht është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës;

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush ndonjë vërejtje sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo atëherë e qes në votim. Konstatohet se unanimisht është aprovuar pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë.

2. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Brendshëm për Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Kryesuesi – Objektivi kryesor i këtij auditimi është që të siguroj se sistemet e kontrollit të brendshëm të vendosura në procesin e shpenzimeve dhe shërbimeve janë adekuate dhe të mjaftueshme për të garantuar se ky proces realizohet sipas procedurave të parapara. Fushëveprimi i auditimit përfshinë periudhën 01.07.2022-30.06.2023. duke përfshirë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me: evidentimin e kujdestarive, kalkulimin e tyre, autorizimin e pagesave të kujdestarive, autorizimin e shpenzimeve, zotimin e mjeteve, evidentimin, raportimin, menaxhimin e kontratave, pranimin e mallrave, menaxhimin e mallrave të pranuar, evidencat e shpenzimeve të karburanteve dhe menaxhimin e veturave. Të gjeturat kryesore gjatë këtij auditimi besoj se i keni para veten në material, dhe mos të ju përsërisë tani unë, por sipas këtij raporti vërehet se ka shumë të gjatuar, rreth 11 të gjetura, pra në 11 pozicione.

Qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është të kryejmë auditimin që do të ju ofroj juve informata të dobishme rreth funksionimit të kontrollit të brendshëm për shpenzimin e parave publike dhe menaxhimin e mallrave dhe shërbimeve në mënyrë efikase. Ku më poshtë i keni të cekure një nga një se cilat kanë qenë objektivat e këtij auditimi.

Të gjeturat: tek zyrtarët e drejtorisë së shëndetësisë në të gjitha proceset e funksionimit të kësaj drejtorie, ne kemi vërejtur se ka të meta të cilat nuk i referohen dizajnit të një kontrolli të mirë të brendshëm me qëllim të menaxhimit sa më efikas dhe ekonomik të parës publike. Gjatë këtij auditimi nuk kemi hasur në një bashkëpunim të mirë me menaxhmentin e kësaj drejtorie, pasi kemi mbajtur takimin fillestar dhe janë njoftuar me objektivat e këtij auditimi, ka qenë një neglizhencë e menaxhmentit dhe stafit tjetër të drejtorisë për ofrimin e dokumentacioneve të kërkuar nga ana e auditorit të brendshëm edhe pse kanë pasur kohë të mjaftueshme rreth 30 ditë pune, nuk kanë arritur të sigurojnë dokumentet e kërkuara për arritjen e objektivave të planifikuara për këtë auditim. Gjatë kësaj periudhe kohore kemi mbajtur disa herë takime me menaxhmentin në drejtorisë dhe janë diskutuar këto çështje por që rezultati ka munguar. Nga 19 objektivat e parapara për këtë auditim, nga stafi i drejtorisë për shëndetësi, kemi arritur që të marrim dokumente dhe mostra vetëm për 4 objektiva të parapara për këtë auditim.

Rekomandim: Rekomandohet krateri i komunës që të ndërmarrë masa të menjëhershme ndaj menaxhmentit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në drejtim të forcimit të kontrollës së brendshme të kësaj drejtorie. Rekomandohet kryetari i komunës dhe menaxhmenti i drejtorisë që të bëjnë veprime të menjëhershme korrigjuese për tu mbrojtur nga një ekspozim i tillë me dobësi të ndjeshme të kontrollit.

A ka dikush nga anëtarët e komitetit të shtoj diçka sa i përket të gjitha këtyre që i prezantove deri më tani.

Skender Hamza – Përsëritet për të gjithë të pranishmit në sallë, e kamë lexuar këtë raport të auditimit të drejtorisë së shëndetësisë, sipas këtij auditimi kjo drejtori ka shumë të gjetura dhe këto të gjetura janë të gjetura shumë shqetësues e për mua. E para për mua është shqetësuese nëse qëndron kështu puna siç e ka paraqitur auditori i brendshëm gjendjen, e pamë se ai ka cekur që bashkëpunimi nuk ka qenë në nivel dhe se mostrat e kërkuara nga auditori nuk ju kanë dhënë ose ofruar. Unë dua të besoj dhe shpresoj që të gjitha këto të gjetura që janë të paraqitura në këtë raport të mos jenë reale në, por nga mungesa e sjellës së mostrave nga ana e zyrtarëve të kësaj drejtorie auditorit i brendshëm e ka paraqitur kështu gjendjen. Sepse të gjeturat janë shumë të ndjeshme, besoj se nëse do të kishte një bashkëpunim më të mirë ky raport do të ishte krejt ndryshe. Prandaj edhe unë si anëtar i këtij komiteti rekomandoj që të ndërmerren masa ndaj të gjithë atyre të cilat nuk kanë bashkëpunuar me sjelljen e mostrave të kërkuara nga auditori i brendshëm.

Kryesuesi - I nderuar auditor, mos ndoshta më mirë kishte me qenë tek rekomandimi të i drejtoresh drejtoreshës e jo menjëherë kryetarit të komunës.

Auditori – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, arsyeja pse ju kamë drejtuar kryetarit është sepse me drejtoresha me zyrtarë ka qene e njoftuar, ne kemi mbajtur takime.

Ardian Rama, Zyrtar nga Drejtoria e Shëndetësisë – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, së pari unë me këtë raporte nuk jam aspak i kënaqur, të gjeturat që i ka cekur auditori i brendshëm për këtë drejtori lirishtë mundem të them se nuk janë të vërteta, të gjitha këto të gjetura ne si drejtori i kemi të argumentuara. ne nuk kemi pasur kërkesë zyrtar nga auditorit rreth materialit të kërkuar, unë kamë përvojë në financa afro 15 vite dhe sa e di auditimi bëhet sipas mostrave, unë për vete nuk kamë pasur asnjë kërkesë nga ana e auditorit rreth materialit të kërkuar. Poashtu kamë dëshmi këtu që disa materiale i kamë dërguar me email rreth të gjeturave të cilat i ka cekë në raporte, unë i kamë të gjitha këtu me vete, disa ja kamë dërguar kurse këtu janë si të gjetura.

Auditori – I nderuar, ti e dinë që ne kemi pasur disa herë takime, ti ke mare pjesë vetëm në një takim. Periudha e auditimit ka qenë 01.07.2022 – 30.06.2023, ti i nderuar më ke dërguar emaila për material pasi që unë e kamë kryer raportin, pra draft raporti vetëm sa ka përfunduar, më pastaj ju më keni sjellë disa materiale. Dhe sa i përket asaj se cilat materiale kamë kërkuar atë unë e përcaktoj se cilat materiale duhet të i sjellësh, nëse të kërkohet edhe komplet arkivin e sjellë.

Blerina Kabashi – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, ky raporte i kryer në drejtorin e shëndetësisë me të vërtet ka shumë të gjetura, por ajo që më ra në sy është një e gjetur e cila edhe vitin e kaluar ka qenë poashtu. Ka qenë rekomandim i ynë që kjo e gjetur të eliminohet, por për fate të keq edhe këtë vite është përsëritur, fjalën e kamë për mos ofrimin e dëshmimeve rreth shpërndarjes së barnave.

Kryesuesi – Para se të kalojmë në pikën e radhës, desha të them që të merret parasysh rekomandimi i auditorit, është rekomandim edhe i ynë si komitet, që **bashkëpunimi me zyrtarët komunalë dhe**

auditorit të jetë në nivele dhe në kohë, tash jemi duke parë që edhe zyrtari për shëndetësi ka disa argumente të cilat na tregojnë se disa të gjetura që janë në këtë raporte kanë mundur mos të jenë nëse këto materiale kishin shkuar me kohë tek auditori. Poashtu edhe auditori ka argumente që materialet i kanë ardhur pasi ka përfunduar raporti në këtë drejtori, prandaj rekomandojmë që bashkëpunimi të jetë me kohë dhe materialet e kërkuara të i dërgohen ashtu siç kërkon auditori.

Kalojmë në pikën e radhës:

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Brendshëm për Drejtorin për Administratë të Përgjithshme.

Kryesuesi – Auditimi në drejtorin e administratës së përgjithshme është kryer në bazë të planit vjetor të njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023. Fushëveprimi i auditimit është periudha 01.01.2023 – 30.06.2023, duke përfshirë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me Auditimin e proceseve të të hyrave, barazimi me zyrtarin për të hyra komunale, shfrytëzimi i automjeteve komunale dhe sistemi i dokumenteve.

Të gjeturat në këtë drejtori janë: Planifikim jo Adekuat i të hyrave, mos barazimi i shumave në mes zyrtarit të drejtorisë për Administratë të përgjithshme dhe zyrtarit të të hyrave komunale. Në bazë të gjeturave të lartpërmendura, kemi formuar opinionin tonë në lidhje me përshtatshmërinë dhe efektivitetin e proceseve, procedurave dhe sistemin e kontroleve të brendshme në drejtorin për Administratë të Përgjithshme për periudhën janar – qershor të vitit 2023 në gjendje aktuale. Kemi dy rekomandime, rekomandimi nr.1. rekomandojmë që Drejtoria e Administratës së Përgjithshme duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet në ndarjet të planifikuara, në mënyrë që të bëhen regjistrimet dhe inkasomi i mirëfilltë i të hyrave vetanake. Rekomandimi nr.2. rekomandojmë Drejtorinë e Administratës, duhet të sigurojë se barazimet në mes të drejtorisë përkatëse dhe zyrtarit kryesor për të hyra komunale të kryehen në baza të rregullta mujore dhe vjetore dhe të gjitha mospërputhjet e mundshme të sqarohen me kohë.

Tek objektivat thuhet në raporte që të sigurohen se sistemet e kontrollit të brendshëm të vendosur në procesin e arkëtimit, barazimit, shfrytëzimi i automjeteve komunale dhe sistemi i dokumenteve, të jenë të mjaftueshme për të garantuar se ky proces realizohet saktë dhe me kohë dhe sipas procedurave të paraparë.

Sa i përket të hyrave sipas këtij raporti thuhet se është vërejtur disa lloje të hyrave nuk ishin bërë planifikime adekuate dhe nuk ishin marrë masa të mjaftueshme për realizimin e ty hyrave. Kjo vërehet tek ngecja në mbledhjen e të hyrave i cili plan nuk ishte përmbushur. Trendi i ty hyrave vetanake për këtë periudhë ka qenë rreth 34%. Departamenti i buxhetit në rastin e planifikimit të të hyrave nuk ka marr parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshirë edhe realizimin e të hyrave gjatë viteve paraprake.

Kurse tek procedurat e marrjes, mirëmbajtjes, parkimit, servisimit dhe raportimit të automjeteve. Duke u bazuar në procedurat kryera të auditimit, ne identifikuam se gjatë rishikimit të dokumenteve kemi

vërejtur se nuk ka mangësi të natyrës praktike, ka evidenca e dokumenteve për përdorimin e automjeteve zyrtare, mbahen raporte dhe të dhëna në elektronik nga zyrtari i njësisë të transportit. Pra konkluzioni sipas këtij raporti është se: Përdorimi i automjeteve zyrtare është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores Komunale për shfrytëzimin e automjeteve të Komunës.

Skender Hamza – Më vije mirë që në këtë raporte nuk kemi shumë të gjetura ose parregullsi, kamë një pyetje për drejtorin? Kur bëhet planifikimi për ndarje të të hyrave, a bëhet një analizë dhe e shikohen edhe vitet paraprake se si ka qenë trendi të hyrave, sepse jemi duke parë që ka dallim të madhe sa i përket planifikimit dhe realizmit.

Besnik Hoti, Drejtor i Administratës së Përgjithshme – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, po gjithmonë kur të bëhet planifikimi ne e bëjmë një analizë dhe gjithmonë i marrim për bazë edhe të hyrat e viteve paraprake, ne i analizojmë se si kanë qenë të hyrat nga vitet paraprake dhe e bëjmë planifikimin për vitin e ardhshëm.

Kryesuesi – Ku qëndron problemi i mos barazimit të zyrtarit përgjegjës nga ana e drejtorisë suaj dhe zyrtarit kryesor për të hyrat komunale, a bëhen këto barazime të të hyrave në baza mujore.

Besnik Hoti – Po i nderuar të hyrat komunale për çdo muaj bëhen barazimet, është zyrtari përgjegjës, poashtu edhe unë jam duke i dhënë shumë rëndësi pasi unë si drejtori dalë leq, por asnjë herë nuk jemi duke u barazuar me zyrtarin kryesor financiar. Duhet të shohim se si do të jetë gjendja në fund të vitit kur të bëhet barazimi, jam tepër kureshtar për këtë.

Kryesuesi – I nderuar drejtor, duhet të shikohet se ku qëndron problemi se nëse ju nuk mundeni të barazoheni në baza mujore, në baza vjetore mendoj se do të jetë edhe më problem.

Besnik Hoti – Jam duke u mundur dhe jam shumë i fokusuar në këtë, nuk e di kemi këtu kolege që janë pjesë e bankave ndoshta munden të na ndihmojnë, sepse shumë herë kamë menduar që mos ndoshta barazimi në bankë bëhet me vonesë pastaj edhe ne nuk po mundemi të barazohemi.

Blerina Kabashi – Barazimet në bankë ndodhin menjëherë, por nëse deponimi ka qenë pas orës 15, atëherë mjetet në xhirollogari do të dalin të nesërmen.

Kryesuesi – Besoj se ky indikator mundet të përmirësohet dhe në vitin e ardhshëm nuk do të jetë më në këtë raporte. A ka dikush të shtojë edhe diçka, nëse jo kalojmë në pikën e fundit.

4. Të ndryshme.

Skender Hamza – Unë desha vetëm një pyetje ose një kërkesë për drejtorin e administratës pasi e kemi këtu, mirë që raporti i auditimit të brendshëm për këtë drejtori që nuk ka pasur shumë të gjetura. Desha një kërkesë, të thjeshtësohet marrja e makinave nga zyrtarët, pra nëse një zyrtar kërkon një makinë që të shkojë në ndonjë trajnim, ka shumë procedura, jo kuponin naftës etj. Të jetë një zyrtar përgjegjës për mbushjen e makinave me derivate dhe zyrtarit i cili kërkon makinën i mbetet vetëm që ta mbushë dëftesën se në cilin drejtim shkon dhe cilat kilometra i ka pasur makina.

Besnik Hoti – Po i nderuar edhe unë jam pro asaj që jeni duke thënë ju, e dini edhe vetë se sa pak makina kamë në dispozicion dhe jam duke u munduar gjithmonë që të gjithë zyrtarët të kenë makina nëse ju

duhen që të shkojnë në trajnime. Jam pro asaj që ju e propozuat, për këtë jemi këtu të bashkëpunojmë dhe të japim ide sa më të mira, pres bashkëpunimin tuaj, ju faleminderit.

Kryesuesi – A ka dikush edhe diçka tek të ndryshmet, nëse jo atëherë ju falënderoj për pjesëmarrje, shihemi në takimet e radhës.

Rahovec, 18.03.2024

Sehad Boshnjaku, Kryesues i Komitetit të Auditimit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2024 merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 5 (pesë) vite të pronës së paluajtshme të komunës duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 206/24 i datës 28.03.2024 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510006-00301-3.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
 - 2.1. **Erhan Morina**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.2. **Besmire Bytyqi**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.3. **Defrim Kafexhiu**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës – LVV;
 - 2.4. **Sejfullah Sejfullahu**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës - PDK
 - 2.5. **Vjollca Gërgule**, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 5 (pesë) vite të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktoj çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, ti zhvillojë procedurat e ankandit publikë dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Anëtarëve të Komisionit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***MAPL-së dhe***
- ***Arkivi***

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C

01 Nr.207/24
Datë:28.03.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*”), dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-213 dhe Ligjin Nr. 08/L-235, dispozitave Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr. 05/L -108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 57 dhe nenit 65 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më dt. 28.03.2024, miraton këtë:

V E N D I M

Për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 dhe 2023, në vitin 2024

1. **Miratohet** propozimi i kryetarit të Komunës, me Nr. Prot. 02/3946/24, i datës 07.03.2024 dhe merret vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 dhe 2023, në vitin 2024, në shumën e përgjithshme prej **654,100.56€ (gjashtëqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind euro e pesëdhjetë e gjashtë cent)**.
2. Mjetet sipas pikës 1 të këtij vendimi do të barten në vitin 2024 në këto programe dhe kategori buxhetore, si në vijim:
 - **Nga fondi Burimor (21) shuma prej 624,253.85:**
 - **Nga fondi Burimor (21) në kategorinë e investimeve kapitale, në shumën prej: 444,253.13€:**
 - 2.1. Në programin: **Administrata dhe Personeli (163)**, nënprogrami: **Administrata (16311)**, kodi funksional **(0133)**.
 - 2.1.1. Ndertimi i E-Kioskut Rahovec, Ratkoc, Krushë e Madhe, kodi (53789), në shumën prej **23,578.00€**.
 - 2.2. Në programin: **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjenca (180)**, nënprogrami: **Infrastruktura Publike (18171)**, kodi funksional **(0451)**.
 - 2.2.1. Ndërtimi i rrugëve në hapësirat për biznes dhe Turizëm në Rahovec (Projekti i ri), në shumën prej **135,271.29€**.
 - 2.3. Në programin: **Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural (470)**, nënprogramin: **Bujqësia (47011)**, kodi funksional **(0421)**.
 - 2.3.1. Ndërtimi i objektit - Depos Bujqësore në Bernjakë, kodi (53797), në shumën prej **80,000.00€**;

2.3.2. Ndërtimi i urave për komunën e Rahovecit (Të specifikohet lokacioni) projekt i ri, në shumën prej **50,000.00€**.

2.4.Në programin: Zhvillimi Ekonomik (480), nënprogramin: Planifikimi dhe zhvillimi Ekonomik (48011), kodi funksional (0411).

2.4.1. Ndërtimi i shtandeve (tezgave) mobile për mbajtjen e panairove (projekt i ri), në shumën prej **5,000.00€**.

2.5.Në programin: Kulturë, Rini, Sport (850), nënshërbimet Kulturore – Rahovec (85011), kodi funksional (0820).

2.5.1. Ndërtimi i Muzeut në Krushë të Madhe, kodi (50753), në shumën prej **20,000.00€**;

2.5.2. Ndërtimi i infrastruktures për aktivitete kulturore në Dejnë dhe sipas prioriteteve, kodi (49943), në shumën prej **5,509.00€**.

2.6.Në programin Arsim dhe Shkencë (920), nënprogramin: Arsimi parashkollor (92410), kodi funksional (0911).

2.6.1. Ndërtimi i çerdhes në Krushë të Madhe, kodi (48202), në shumën prej **34,894.84€**.

2.7.Në programin: Arsim dhe Shkencë (920), nënprogramin: Arsimi fillor, i mesëm i ulët (93300), kodi funksional (0912).

2.7.1. Renovimet në shkollat Rahovec, Çifllak, Zoqishtë, kodi (53783), në shumë prej **50,000.00€**;

2.7.2. Rrethimi i oborreve të shkollave (projekt i ri), në shumën prej **40,000.00€**.

- *Nga fondi burimor (21) në kategorinë: Subvencione dhe transfere, në shumë prej 100,000.00€:*

2.8.Në programin: Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia (180), nënprogrami: Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451). Në shumën prej 99,600.00€.

2.9.Në programin: Shëndetësia dhe mirëqenia sociale (730), nënprogrami: Shërbimet e shëndetësisë primare (73700), kodi funksional (0721), në shumën prej 400.00€.

- *Nga fondi burimor (21) në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve, në shumën prej 80,000.72€:*

2.10. Në programin: Administrata dhe Personeli (163), nënprogrami: Administrata (16311), kodi funksional (0133), në shumën prej 30,000.00€.

2.11. Në programin: Planifikimi urban dhe mjedis (660), nënprogramin: Planifikimi Urban dhe Inspeksion (66360), kodi funksional (0620). Në shumën prej 50,000.72€.

- **Nga fondi Burimor (22), shuma prej 29,846.71€**

- *Nga fondi Burimor (22), në kategorinë e investimeve kapitale, në shumën prej 29,846.71€:*

2.12. Në programin: Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia (180), nënprogrami: Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451).

2.12.1. Ndërtimi i rrugëve në hapësirat për biznes dhe turizëm në Rahovec (Projekt i ri), në shumën prej **20,146.71€**.

2.13. Në programin: Arsim dhe Shkencë (920), nënprogramin: Arsimi parashkollor (92410), kodi funksional (0911).

2.13.1. Blerja teknologjisë informative, shkollat Ratkoc, Rahovec, Vrajak, Fortesë etj. Kodi (53784), në shumën prej **9,700.00€**.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Me vendim të njoftohen:

- **Kryetari i Komunës,**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa,**
- **MAPL-ja, dhe**
- **Arkivi.**

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C

01 Nr.____/2024

Datë: 28.03.2024

Arbër Zenuni

Kryesues

i

Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013”), Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2024, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit të futbollit në Rahovec

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/4010/24 i datës 28.03.2024 dhe merret vendimi për **caktimin** e lokacionit për ndërtimin e stadiumit të futbollit në Rahovec.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510006-00231-8 me sipërfaqe të përgjithshme prej 35000m² (tridhjetë e pesë mijë metra katror), Zona Kadastrale Bërnjak, në vendin e quajtur Palatica, e evidentuar në emër të Komuna e Rahovecit.
3. Parcela në sipërfaqe prej 35000m² (tridhjetë e pesë mijë metra katror) sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2023-2031 me Nr. Prot. 01 Nr. 182/24 i datës 30.01.2024 ka destinim Tokë Ndërtimore.
4. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
5. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë regjistrimin e gjendjes në librat kadastral.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe*
- *Arkivi.*

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01-Nr.209/24
Me datë:28.03.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008*”), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8, nenit 16 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2024 merr këtë:

V E N D I M
Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/3948/24 i datës 08.03.2024 dhe merret vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim për organizatat e shoqërisë civile dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi është në zonën kadastrale Bërnjak, në vendin e quajtur grlo-vrnjaqka, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510006-00301-3, në sipërfaqe prej 486m² (katërqind e tetëdhjetë e gjashtë metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1500m² (njëmijë e pesëqind metra katror), duke përfshirë edhe objektin, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin e aktiviteteve të shoqërisë civile me qëllim të promovimit të turizmit në Komunën e Rahovecit, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej 5 (pesë) vite.
5. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t’i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
6. Çmimi fillestar i pronës komunale duke përfshirë edhe objektin, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi do të jetë 1€ (një euro) në muaj.
7. Obligohen Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien

e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvilloj procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

8. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
9. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C

01-Nr.206/24
Me datë:28.03.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12, pika 1 dhe 2, shkronja d, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, nenit 21 paragrafi 2 pika 2.3 e Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr 01/1427 e datës 28.04.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec, në mbledhjen e mbajtur më dt. 28.03.2024, miraton këtë:

V E N D I M

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës, me Nr. Prot. 02/3992, i datës 19.03.2024 dhe merret vendimi për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Rahovecit, në shumën prej 220€ (dyqind e njëzet euro) për çdo rast, për vitin 2024.
2. Në kuadër të shpenzimeve të varrimit, bëjnë pjesë: Regjistrimi i rastit në librin amëz i të vdekurit, fletë-lajmërimet (afishet), pastrimi i kufomës me mjetet higjienike për pastrim, hapja e varrit, sigurimi i dërrasave, pëlhura për mbështjelljen e kufomës (qefinit), piramida me mbishkrim, transporti i kufomës nga shtëpia deri në varreza dhe kryerja e ritualeve të varrimit, sipas parimeve fetare (përgjashtimisht rasteve kur një gjë e tillë nuk kërkohet nga ana e qytetarëve të caktuar).
3. **OBLIGOHEN** bashkësitë fetare në Komunën e Rahovecit që, në baza mujore, të dërgojnë listën e personave të vdekur, duke bashkëngjitur fletëregjistrimin për çdo person të vdekur.
4. **AUTORIZOHET** kryetari i Komunës që, pas pranimi të listës, sipas pikës 3 të këtij vendimi, të marrë vendim për ekzekutimin e mjeteve në shumën e cila do të jetë sipas listës dhe atë në xhirollogari të bashkësive fetare.
5. **OBLIGOHET** kryetari i Komunës që të formojë komision në përbërje prej 3 (tre) anëtarësh, për mbikëqyrjen e realizimit të këtij vendimi.
6. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve dhe transfereve.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës dhe drejtorët e Drejtorive në Komunën e Rahovecit.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorëve të drejtorive,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01Nr.208/24

Datë:28.03.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 dhe nenin 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.03.2024 miraton këtë:

V E N D I M

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/3946/24 i datës 07.03.2024 dhe merret vendimi për ndarjen e parcelës P-71510057-02658-0 në zonën kadastrale Rahovec, në sipërfaqe të përgjithshme prej 20972m² (njëzetmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy metra katror) në vendin e quajtur krajishnica, në emër të Komuna e Rahovecit dhe formimin e parcelës së re në sipërfaqe prej 775m² (shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë metra katror).
2. Parcela e re në sipërfaqe prej 775m² (shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë metra katror) do të evidentohet në emër të Komuna e Rahovecit.
3. Qëllimi i ndarjes së parcelës sipas pikës 1 të këtij vendimi është qasja më e lehtë e qytetarëve në rrugën publike – Tranziti.
4. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë ndarjen e parcelës, kufizimin dhe regjistrimin në librat kadastral.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Kryetarit të Komunës,**
- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01Nr.205/24
Datë:28.03.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*”), nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Shkresës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me Nr. Prot. 1410-2/24 e datës 21.03.2024, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2024 merr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit 01 Nr. 197/24 i datës 29.02.2024 për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit

1. Me këtë vendim **shfuqizohet** vendimi me Nr. Prot. 01 Nr. 197/24 i datës 29.02.2024 për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit.
2. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **MAPL-së,**
- **Kryetarit të Komunës,**
- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.210/24
Datë:28.03.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit